



---

## **HAPËSIRA HISTORIKE URBANE**

*Korniza e funksionalizimit  
për Çarshinë e Madhe në Gjakovë*

---

## **HISTORIC URBAN AREA**


*Framework for the regeneration  
of the Great Bazaar in Gjakova*

CH  
WB

Cultural  
Heritage without Borders  
TRASHËGIMIA KULTUROR PA KUFJ



Komuna e Gjakovës  
Opština Đakovica  
Municipality of Gjakova



---

## **HAPËSIRA HISTORIKE URBANE**

*Korniza e funksionalizimit  
për Çarshinë e Madhe në Gjakovë*

---

---

## **HISTORIC URBAN AREA**

*Framework for the regeneration  
of the Great Bazaar in Gjakova*



# PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave .....	4
FALËNDERIMET .....	8
<b>I. Historiku i Çarshisë së Madhe .....</b>	<b>15</b>
<b>II. Procesi.....</b>	<b>19</b>
Ideja e projektit.....	20
Gjendja ekzistuese .....	28
Analiza SWOT.....	40
<b>III. VIZIONI, PARIMET dhe SYNIMET KRYESORE.....</b>	<b>53</b>
<b>IV. KORNIZA STRATEGJIKE E FUNKSIONALIZIMIT .....</b>	<b>59</b>
<b>SYNIMI 1</b>	
KRIJIMI I KORNIZËS ORGANIZATIVE .....	61
OBJEKTIVI 1.1 – THEMELIMI I NJËSISË PËR MENAXHIMIN E ÇARSHISË SË MADHE (NMÇ) .....	62
Veprimi 1.1.1 – Formimi i grupit punues për themelimin e NMÇ-së .....	62
Veprimi 1.1.2 – Organizimi i NMÇ-së (propozimet) .....	64
Veprimi 1.1.3 – Përcaktimi i mandatit të NMÇ-së.....	68
Veprimi 1.1.4 – Ndërtimi i linjve të qëndrueshme të bashkëpunimit .....	68
OBJEKTIVI 1.2 – SIGURIMI I QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE.....	70
Veprimi 1.2.1 – Marrëveshja financiare MKRS-Komuna-NMC.....	70
Veprimi 1.2.2 – Përcaktimi i pagesave të participimit dhe shërbimeve.....	70
Veprimi 1.2.3 – Lobimi për ngritjen e fondeve .....	72
OBJEKTIVI 1.3 – MBROJTJA E ZEJEVE NË ZHDIKJE.....	72
Veprimi 1.3.1 – Evidentimi i listës së zejeve të rrezikuara .....	72
Veprimi 1.3.2 – Vendosja e mekanizmit për ndihmë,subvencionim të zejeve të rrezikuara .....	72
<b>SYNIMI 2</b>	
RUAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I VEÇANTISË SË ÇARSHISË .....	75
OBJEKTIVI 2.1 – SHNDËRRIMI I ÇARSHISË NË DESTINACION TURISTIK.....	76
Veprimi 2.1.1 – Intensifikimi i bashkëpunimit me iniciativat turistike rajonale .....	76
Veprimi 2.1.2 – Brendimi i Çarshisë së Madhe .....	76
Veprimi 2.1.3 – Promovimi i Çarshisë së Madhe si destinacion turistik.....	78
OBJEKTIVI 2.2 – NGRITJA E VETËDIJES PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE.....	80
Veprimi 2.2.1 – Zhvillimi i programit për vetëdijësim të fëmijëve dhe të rinjëve .....	80
Veprimi 2.2.2 – Vizitat në muze dhe në lokacionet e trashëgimisë.....	82
Veprimi 2.2.3 – Vizitat në punëtoritë e zejeve tradicionale .....	82
Veprimi 2.2.4 – Publikimi i materialeve vetëdijësuese .....	82
OBJEKTIVI 2.3 – MENAXHIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE .....	82
Veprimi 2.3.1 – Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Çarshisë së Madhe.....	84
Veprimi 2.3.2 – Ri-përdorimi i objekteve të trashëgimisë.....	86
<b>SYNIMI 3</b>	
ZHVILLIMI I LËVIZSHMËRISË, TRAFIKUT DHE NGRITJA E KUALITETIT TË HAPËSIRAVE PUBLIKE .....	87
OBJEKTIVI 3.1 – REDUKTIMI I KONFLIKTEVE NË MES KËMBËSORËVE DHE AUTOMJETEVE .....	88
Veprimi 3.1.1 – Ndryshimi i sistemit të lëvizshmërisë, trafikut në zonë dhe përreth saj .....	88
Veprimi 3.1.2 – Përcaktimi dhe rregullimi i hapësirave për parking .....	92
OBJEKTIVI 3.2 – PËRCAKTIMI I ZONAVE DHE PËRMIRËSIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE .....	92
Veprimi 3.2.1 – Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm .....	92
Veprimi 3.2.2 – Hartimi i Studimit, Bazat e konservimit .....	98
Koncepti i zhvillimit të lëvizshmërisë .....	100
<b>V. Plani i veprimit .....</b>	<b>102</b>

# CONTENT

Abbreviations.....	7
ACKNOWLEDGMENTS .....	9
I. The history of the Great Bazaar .....	15
II. The Process.....	19
The idea of the project .....	21
The existing situation .....	29
SWOT Analysis .....	41
<b>III. VISION, PRINCIPLES and MAIN GOALS.....</b>	<b>53</b>
<b>IV. STRATEGIC FRAMEWORK OF REGENERATION .....</b>	<b>59</b>
<b>AIM 1</b>	
CREATING THE ORGANIZATIONAL FRAMEWORK .....	61
OBJECTIVE 1.1 – THE ESTABLISHMENT OF THE MANAGING UNIT OF THE GREAT BAZAAR (MUGB) .....	63
Activity 1.1.1 – Creating the working group for the establishment of the MUGB.....	63
Activity 1.1.2 – Organization of MUGB (proposals) .....	65
Activity 1.1.3 – Determination of the MUGB mandate .....	69
Activity 1.1.4 – Building sustainable lines of cooperation .....	69
OBJECTIVE 1.2 – ENSURING THE FINANCIAL VIABILITY .....	71
Activity 1.2.1 – Financial agreement MCYS- Municipality- MUGB .....	71
Activity 1.2.2 – Determination of participation and utility payments .....	71
Activity 1.2.3 – Lobbying for fundraising .....	73
OBJECTIVE 1.3 – PROTECTION OF CRAFTS IN EXTINCTION .....	73
Activity 1.3.1 – Identifying the list of endangered crafts .....	73
Activity 1.3.2 – The establishment of a mechanism for assistance/ subsidy for endangered crafts .....	73
<b>AIM 2</b>	
THE PRESERVATION AND USE OF THE UNIQUENESS OF THE GRAND BAZAAR ....	75
OBJECTIVE 2.1 – THE CONVERSION OF BAZAAR IN TOURISM DESTINATION FOR THE MUNICIPALITY AND REGION .....	77
Activity 2.1.1 – Intensification of cooperation with regional tourism initiatives .....	77
Activity 2.1.2 – Branding of the Great Bazaar .....	77
Activity 2.1.3 – Promoting the Great Bazaar as a tourist destination .....	79
OBJECTIVE 2.2 - RAISING AWARENESS FOR CULTURAL HERITAGE PRESERVATION .....	81
Activity 2.2.1 – Development of awareness program for children and youth.....	81
Activity 2.2.2- Visits to museums and heritage sites .....	83
Activity 2.2.3 – Visits to workshops of traditional crafts .....	83
Activity 2.2.4 – Publication of awareness materials.....	83
OBJECTIVE 2.3 – CULTURAL HERITAGE MANAGEMENT .....	83
Activity 2.3.1 – Drafting the Management Plan of the Great Bazaar.....	83
Activity 2.3.2 – Adaptive reuse of built heritage .....	85
<b>AIM 3</b>	
DEVELOPING MOBILITY/ TRAFFIC AND IMPROVING THE QUALITY OF PUBLIC SPACES.....	87
OBJECTIVE 3.1 – REDUCING CONFLICTS BETWEEN PEDESTRIANS AND VEHICLES.....	89
Activity 3.1.1- Changing the mobility/ traffic system in the area and its surroundings .....	89
Activity 3.1.2 - Determination and regulation of parking spaces .....	93
OBJECTIVE 3.2 DETERMINATION OF FUNCTIONAL AREAS AND IMPROVING THE PUBLIC SPACE .....	93
Activity 3.2.1 – Development of Detailed Regulatory Plan .....	93
Activity 3.2.2 – Drafting the Study / The conservation basis .....	99
The concept of mobility development .....	101
<b>V. Action Plan.....</b>	<b>103</b>

**LISTA E SHKURTESAVE**

<b>CHwB</b>	Fondacioni Suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij
<b>QRTK</b>	QRTK Gjakovë
<b>DTK</b>	Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në kuadër të MKRS-së
<b>DUMM</b>	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
<b>DZHE</b>	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
<b>IPH</b>	Instituti për Planifikim Hapësinor
<b>Korniza</b>	Korniza e funksionalizimit të Çarshisë së Madhe
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>NMÇ</b>	Njësia për Menaxhimin e Çarshisë
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>PLTK</b>	Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore
<b>TK</b>	Trashëgimia kulturore
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

**ABBREVIATIONS**

<b>CHwB</b>	Swedish foundation Cultural Heritage without Borders
<b>RCCH</b>	Regional Center for Cultural Heritage
<b>DCH</b>	Department of Cultural Heritage within MCYS
<b>DUEP</b>	Department of Urbanism and Environmental Protection
<b>DEC</b>	Department of Economic Development
<b>ISP</b>	Institute of Spatial Planning
<b>Framework</b>	Framework for the regeneration of the Great Bazaar
<b>MCYS</b>	Ministry of Culture, Youth and Sport
<b>MESP</b>	Ministry of Environment and Spatial Planning
<b>MUB</b>	Managing Unit of the Bazaar
<b>NGO</b>	Non-Governmental Organization
<b>LCHP</b>	Local Cultural Heritage Plan
<b>CH</b>	Cultural Heritage
<b>USAID</b>	United States Agency for International Development



## EKIPI I PROJEKTIT DHE I PUBLIKIMIT

**Menaxher i projektit:** Dukagjin Bakija

**Botues:** Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), zyra në Kosovë

**Titulli:** HAPËSIRA HISTORIKE URBANE Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë

**Financuar nga:** Suedia përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar

**Tekstet:** Dukagjin Bakija dhe Drita Nushi

**Fotografitë:** QRTK Gjakovë dhe CHwB

**Lekturimi në gjuhën shqipe:** Vlorë Berisha

**Përkthimi në gjuhën angleze:** Kaltrina Thaçi

**Shtypi & Dizajni:** ASHA / [www.ashagraphics.com](http://www.ashagraphics.com)

**Tirazhi:** 300 copë

## PROJECT TEAM AND PUBLICATION

**Project Manager:** Dukagjin Bakija

**Publisher:** Cultural Heritage without Borders (CHwB), office in Kosovo

**Title:** HISTORIC URBAN AREA: Framework for the regeneration of the Great Bazaar in Gjakova

**Funded by:** Sweden through Swedish International Development Cooperation Agency

**Texts:** Dukagjin Bakija dhe Drita Nushi

**Photos:** QRTK Gjakovë dhe CHwB

**Proofreading in albanian:** Vlorë Berisha

**Translation in english:** Kaltrina Thaçi

**Design & Print:** ASHA / [www.ashagraphics.com](http://www.ashagraphics.com)

**Printed copies:** 300

## FALËNDERIMET

**P**ublikimi i dokumentit "Hapësira Historike Urbane - Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë" shënon përmbylljen e një procesi gjithpërfshirës i cili ka filluar në fillim të vitit 2015. Ky dokument që është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet ekipit të CHwB-së, zyrtarëve komunal, përfaqësuesve të institucioneve qeveritare dhe komunitetit të Çarshisë së Madhe, e përmbledhë hulumtimin dhe analizën e kryer për funksionalizimin e Çarshisë dhe ofron një sërë rekomandimesh për ringjalljen e saj.

Organizimi i pjesëmarrjes publike gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti është zhvilluar si pjesë e projektit të financuar nga USAID, Partnership for Development dhe zbatuar nga Komuna e Gjakovës në partneritet me Fondacionin Suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB). Në kuadër të projektit është themeluar Grupi Këshillues i Komunitetit, i cili ka pasur për qëllim të shërbejë si urë lidhëse në mes të komunitetit dhe institucionit të komunës për një pjesëmarrje aktive të publikut në procesin e hartimit të dokumentit për funksionalizimin e Çarshisë së Madhe. GKK i përbërë nga përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të komunitetit nga zona e projektit (banorët, pronarët e dyqaneve, zejtarët, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve relevante), ka ndihmuar procesin pjesëmarrës duke paraqitur çështjet me rëndësi dhe prioritetet për komunitetin, dhe duke dhënë propozime dhe ide lidhur me funksionalizimin e Çarshisë së Madhe.

*Do të donim ti shprehim falënderimet e sinqerta për të gjithë ekspertët të cilët kanë kontribuar në këtë proces, në veçanti Grupin punues të projektit:*

- **Mimoza Kusari-Lila**, Kryetare e Komunës Gjakovës
- **Silvana Domi**, Komuna Gjakovë/Drejtorja për Zhvillim Ekonomik
- **Xhelal Hoxha**, Komuna Gjakovë, Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- **Meriton Ferizi**, Komuna Gjakovë/Drejtorja e Rinisë, Kulturës dhe Sportit
- **Burim Meqa**, Komuna Gjakovë/Drejtorja për Shërbime Publike
- **Shkumbin Kastrati**, Komuna Gjakovë/Drejtorja për Shërbime Publike

## ACKNOWLEDGEMENTS

**T**he publication of the document "Historic Urban Space - the framework for the regeneration of the Great Bazaar in Gjakova" marks the conclusion of a comprehensive process, which started at the beginning of 2015. This document, which is the result of cooperation between CHwB team, municipal officials, representatives of governmental institutions and community of the Grand Bazaar, summarizes the research and analysis conducted for the regeneration of the Bazaar and offers a series of recommendations for its revival.

The organization of public participation in the process of drafting this document was developed as part of the USAID-funded project, Partnership for Development and implemented by the Municipality of Gjakova in partnership with the Swedish Foundation Cultural Heritage without Borders (CHwB). Within the project was established the Community Advisory Group, which was intended to serve as a bridge between the community and the municipal institution for active public participation in the process of drafting the document for the regeneration of the Grand Bazaar. CAG, comprised of representatives of various community groups from the area of the project (residents, shop owners, craftsmen, businesses, civil society organizations and representatives of relevant institutions), has assisted the participatory process by presenting important issues and priorities for the community, and giving proposals and ideas related to the regeneration of the Grand Bazaar.

*We would like to express our sincere gratitude to all the experts who have contributed to this process, in particular the Working Group of the project:*

- **Mimoza Kusari-Lila**, Mayor of Gjakova Municipality
- **Silvana Domi**, Municipality of Gjakova/ Department of Economic Development
- **Xhelal Hoxha**, Municipality of Gjakova/ Department of Urbanism and Environmental Protection
- **Meriton Ferizi**, Municipality of Gjakova /Department of Youth, Culture and Sport
- **Burim Meqa**, Municipality of Gjakova/ Department of Public Services
- **Shkumbin Kastrati**, Municipality of Gjakova/ Department of Public Services



- **Luan Nushi**, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/IPH
- **Burbuqe Bakija Deva**, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/DTK
- **Osman Gojani**, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /QRTK Gjakovë
- **Drenushë Behluli Mehmeti**, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/DTK
- **Kujtim Rrahmani**, Zyra Informativë Turistike
- **Agron Gojani**, Komuna e Gjakovës/Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- **Mirlinda Dana Nagavci**, Asociacioni Gjakova-Basel
- **Shkelzen Saraqini**, Muzeu Regjional Etnografik i Gjakovës
- **Sali Shoshi**, CHwB / Trashëgimia Kulturore pa Kufij
- **Enes Toska**, CHwB / Trashëgimia Kulturore pa Kufij
- **Drita Nushi**, Koordinatore e projektit “Promovimi i Pjesëmarrjes së Publikut në Planifikim Hapësinor në Nivel Lokal”, CHwB / Trashëgimia Kulturore pa Kufij
- **USAID**, Partneriteti për zhvillim (Organizatë partnere e cila ka përkrahur procesin e pjesëmarrjes publike)

Gjthashtu do të donim t’u shprehim mirënjohjen tonë të gjithë anëtarëve të Grupit Këshillues të Komunitetit, për kontributin e tyre gjatë punës dhe takimeve të rregullta të organizuara nga ekipi i CHwB-së dhe DUMM:

Sahit Mula	Ibrahim Rudi	Enver Pula
Faton Deva	Donika Lama-Efendija	Agron Gojani
Agron Lama	Elida Shasivari	Lulzim Jupa
Ali Haraqia	Faton Pruthi	Visar Koshi
Valbona Rizvanolli	Luan Qukani	Shqipe Bejtullahu
Marsel Seba	Visar Haxhibeqiri	Jona Komoni
Eli Bytyqi	Zeki Vehapi	Gresa Smolica
Shkelzen Rexha	Vegim Hoxha	

- **Luan Nushi**, Ministry of Environment and Spatial Planning/ ISP
- **Burbuqe Bakija Deva**, Ministry of Culture, Youth and Sport/ DCH
- **Osman Gojani**, Ministry of Culture, Youth and Sport/ RCCH
- **Drenushë Behluli Mehmeti**, Ministry of Culture, Youth and Sport/ DCH
- **Kujtim Rrahmani**, Tourist Information Office
- **Agron Gojani**, Municipality of Gjakova/ Department of Urbanism and Environmental Protection
- **Mirlinda Dana Nagavci**, Association Gjakova-Basel
- **Shkelzen Saraqini**, Regional Ethnographic Museum of Gjakova
- **Sali Shoshi**, CHwB / Cultural Heritage without Borders
- **Enes Toska**, CHwB / Cultural Heritage without Borders
- **Drita Nushi**, Coordinator of the project “Promoting Public Participation in Spatial Planning at the Local Level”, CHwB / Cultural Heritage without Borders
- **USAID**, Partnership for Development (Partner organization that supported public participation)

We would like to express our gratitude to all members of the Community Advisory Group for their contribution during regular workshops and meetings, organized by CHwB team and DUEP:

Sahit Mula	Ibrahim Rudi	Enver Pula
Faton Deva	Donika Lama-Efendija	Agron Gojani
Agron Lama	Elida Shasivari	Lulzim Jupa
Ali Haraqia	Faton Pruthi	Visar Koshi
Valbona Rizvanolli	Luan Qukani	Shqipe Bejtullahu
Marsel Seba	Visar Haxhibeqiri	Jona Komoni
Eli Bytyqi	Zeki Vehapi	Gresa Smolica
Shkelzen Rexha	Vegim Hoxha	

**I. HISTORIKU  
I ÇARSHISË SË MADHE**

---

***I. THE HISTORY  
OF THE GRAND BAZAAR***





**E**dhe pse ka fakte që treva e Gjakovës ka qenë e banuar që nga antika, shënimet e para historike ku përmendet si fshat datojnë nga shekulli XV. I ndodhur në kryqëzimin e rrugëve të shumta rajonale dhe ndërrajonale që lidhnin bregdetin Adriatik me brendësinë e Ballkanit dhe më tej me Azinë e Vogël, vendbanimi i atëhershëm ka pasur rëndësi të jashtëzakonshme si vend i mbajtjes së tregut, për çfarë përmendet qysh më 1485. Si të tillë e gjejmë edhe në defteret osmane të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582.

I ndërtuar më 1003 Hixhri (1594/95) ansambli i Xhamisë së Hadumit me objektet përcjellëse: mejtepin, bibliotekën, hanin, hamamin dhe muvakit hanën, dhe disa dyqane në të cilat u vendosën zejtarët e parë, ka krijuar bërthamën rreth së cilës u zhvillua Çarshia e Madhe. Kjo shënon edhe filltet e zhvillimit të qytetit të Gjakovës, i cili falë pozitës së favorshme gjeografike dhe rëndësisë strategjike ka shfaqur një zhvillim të shpejtë ekonomik dhe shoqëror, duke u bërë qendër me zejtarë e tregtarë të zhvilluar.



Çarshia e Madhe përmban 525 objekte dhe njihet si çarshia më e madhe në Evropën Juglindore. Aty zhvilloheshin gati të gjitha llojet e zejeve të lidhura me një sistem zingjiror të prodhimit dhe tregtisë (përpunimi i metaleve, lëkurës, tekstilit, drurit, etj.) dhe shërbimeve. Deri në vitet e 70-ta të shekullit XIX kishte një lidhje të fuqishme tregtare me Shkodrën (Shqipërinë), që mundësoi eksportimin e prodhimeve në vendet e largëta dhe furnizimin me mallëra

**A**lthough there is evidence that the region of Gjakova has been inhabited since ancient times, the first historical records, where it is mentioned as a village, dates from the fifteenth century. Situated at the crossroads of many regions and intraregions, connecting the Adriatic coast with the inside of the Balkans and further to Asia Minor, the then settlement had an extraordinary importance as a market place, mentioned as such since 1485. It is also mentioned in 1582 at Ottoman Deftera of the Sanjak of Shkodra.

Built in 1003 Hijri (1594/95), the ensemble of Hadum Mosque with accompanying buildings: *mejtep* (Religious school), library, inn, *hamam* (Turkish bath), muvakit hanën and some stores settled by the first craftsmen, it has created the core around which was developed the Great Bazaar. This development marks the beginnings of the town of Gjakova, which thanks to its favorable geographic position and strategic importance has shown rapid economic and social development, becoming the center of trade with developed crafts.



The Grand Bazaar has 525 buildings and is known as the largest bazaar in the Eastern Europe. It has developed almost all kinds of crafts related to a chain system of production and trade (processing of metals, leather, textile, wood, etc.) and services. Until the 70s of the 19<sup>th</sup> century, it had a strong trading links with Shkodra (Albania), which enabled the export of products in remote areas and luxury goods supply and colonial items (Shkodra- Kosova- Nish-



luksozë dhe artikuj kolonialë (Shkodër-Kosovë-Nish-Sofje-Konstantinopojë). Me ndërtimin e hekurudhës Selanik-Shkup-Mitrovicë (1873), tregtia orientohet kah qytetet e Kosovës, Sanxhaku, Shkupi e Selaniku.

Përpos funksionit ekonomik, Çarshia ishte edhe qendër e zhvillimit të jetës shoqërore dhe politike të qytetit. Esnafet si forma të organizimit të zejtarëve kanë luajtur rol të rëndësishëm në strukturën shoqërore dhe ekonomike të Çarshisë. Në veçanti janë shquar esnafet e terzive dhe tabakëve të cilët gjatë shekullit XVIII e forcuan pushtetin e tyre në Çarshi karshi autoriteteve qeveritare lokale. Respektimi i rregullave të vendosura nga esnafet, i ka ruajtur zejjet dhe e ka bartur traditën e tyre brez pas brezi.

Ky zhvillim i hovshëm është ndërprerë dhunshëm me shkatërrimin e Çarshisë më 1912 gjatë periudhës së luftërave Ballkanike. Me fillimin e importit të prodhimeve industriale, në periudhën në mes të dy luftërave, është shënuar rënie e vazhdueshme e zejtarisë, si pasojë e konkurrencës së prodhimeve të importuara industriale.

Pas luftës së dytë botërore, me hapjen e fabrikave dhe zhvendosjen e aktiviteteve ekonomike të qytetit në bregun e majtë të lumit Krena, Çarshia e Madhe e ka humbur rolin e saj si qendër ekonomike. Gjatë luftës së fundit (1999) ajo u shkatërrua përsëri, mirëpo me ndihmën e donacioneve është rikonstruktuar dhe sot është kompleks kulturo-historik, turistik dhe zejtar. Përkundër ngjarjeve të bujshme historike, dhe adaptimit të vazhdueshëm ndaj nevojave të kohës, Çarshia e Madhe e ka formuar dhe ruajtur skemën origjinale të bazës planore, me mënyrën specifike orientale të ndërtimit dhe grupimit të objekteve, duke krijuar një nga tërësitë më të veçanta të arkitekturës popullore në Kosovë dhe me gjërë. Ajo shquhet për veçoritë, shprehjet arkitektonike

të objekteve, format e tyre fisnike dhe dimensionet njerëzore dhe paraqet një nga tërësitë e rralla të ruajtura të tipit ballkanik-oriental. Prandaj, për shkak të rëndësisë së vlerave kulturore dhe historike, tërësia urbanistike e Çarshisë së Madhe është nën mbrojtje të përkohshme me vendimin nr.59/55 të datës 19.02.1955.



Sofia- Constantinople). With the construction of the Thessaloniki- Skopje-Mitrovica railway (1873), the trade was oriented towards the cities of Kosova, Sandzak, Skopje and Thessaloniki.

Besides the economic function, the Bazaar was also the center of the development of social and political life of the city. The guilds, as forms of organization of craftsmen, have played an important role in the social and economic structure of the bazaar. In particular were distinguished the guilds of tailors and trays, which during the XVIII century strengthened their power in the Bazaar against local government authorities. Sticking to the rules set by the guilds, it has preserved the crafts and transferred their tradition from generation to generation.

This rapid development was interrupted violently by the destruction of the bazaar in 1912, during the Balkan wars. With the beginning of the import of industrial products, in the period between the two wars, was marked a continuous decrease of handicrafts, as a result of competition of imported industrial products.

After World War II, with the opening of factories and the relocation of economic activities of the city on the left bank of the river Krena, the Grand Bazaar lost its role as the economic center. During the last war (1999), it was destroyed again, but with the help of donations it was renovated and today is a cultural-historical, tourist and craftsman complex. Despite the events of history and continuous adaptation to the needs of the time, the Grand Bazaar has formed and preserved the original planning scheme, with specific oriental method of construction and grouping of buildings, creating one of the most special complexes of folk architecture in Kosovo and beyond. It is known for features, architectural expressions of buildings, their noble shapes and human dimensions, and represents a rare preserved entirety Balkan-oriental type. Therefore, because of the importance of cultural and historical values, the urban entirety of the Great Bazaar is under protection by the decision No. 59 / 55 dated 02.19.1955.





## II. PROCESI

---

## *II. THE PROCESS*



## Ideja e projektit

Ideja për hartimin e këtij dokumenti ka rrjedhë nga puna që është bërë në Forumin Lokal për Trashëgimi Kulturor të Gjakovës, të themeluar në kuadër të Programit të Planeve Lokale të Trashëgimisë Kulturorë 2012-2015 të zbatuar nga CHwB dhe të financuar nga shteti Suedez. Rezultat i punës së Forumit ka qenë lista e projekteve me prioritet të trashëgimisë kulturorë për Komunën e Gjakovës. Në kuadër të Listës është paraparë edhe Projekti “Hartimi i Strategjisë për Rifunksionalizimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës” që është cilësuar si njëri ndër projektet e rëndësishme me ndikim në zhvillimin e komunës në përgjithësi.

## Hartimi i dokumentit

Më 1 Tetor 2012 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për Programin “Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturorë 2012-2015” (PLTK) në mes të Trashëgimisë Kulturorë pa Kufij (CHwB) dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Komunave të Dragashit, Gjakovës, Gjilanit, Kaçanikut, Parteshit, Rahovecit dhe Vushtrrisë. Ky Program do të kontribuojë në fuqizimin e rolit të komunave, OJQ-ve dhe komunitetit në ringjalljen e trashëgimisë kulturorë lokale dhe natyrore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të tyre për qëllime të zhvillimit ekonomik lokal në shtatë komunat partnere.

Tri qëllimet kryesore të Programit janë: 1. Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturorë dhe natyrore; 2. Integrimi i trashëgimisë kulturorë dhe natyrore në jetën bashkëkohore dhe zhvillim lokal; dhe 3. Edukimi, trajnimet dhe ngritja e vetëdijes mbi trashëgiminë kulturorë dhe natyrore.

Një nga fokuset kryesore të programit ka qenë themelimi i Forumeve Lokale në çdo komunë partnere. Forumi Lokal i Trashëgimisë Kulturorë të Gjakovës përbëhet nga gjithsej 20 anëtarë, me më shumë se gjysmën e anëtarëve nga komuna përkatëse, përfaqësues të institucioneve qendrore, autoritete lokale, organizata ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Katër rolet kryesore të Forumeve ishin: komunikimi dhe koordinimi ndër-institucional; trupi vendimmarrës në hartimin e planeve dhe përcaktimin e prioritetëve; monitorimi dhe roli mbështetës në implementimin e prioritetëve të dala nga planet dhe partnerët implementues në një numër prioritetesh të dala nga planet.

Në Korrik të vitit 2013 Forumi Lokal përfundoi hartimin e Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturorë (PLTK) të Komunës së Gjakovës. Ky plan përpos analizave të ndryshme përmban mbi 40 prioritetet të identifikuara për mbrojtje

## The idea of the project

The idea of this document has derived from the work of the Local Cultural Heritage Forum in Gjakova, established within the Program of “Local Cultural Heritage Plans 2012-2015”, implemented by CHwB - and funded by the Sweden. The result of the work of Forum was a priority list of projects for cultural heritage of the municipality. In the framework list, the project ‘Draft Strategy for regeneration of the Great Bazaar in Gjakova’, was also envisaged as one of the important projects effecting the development of the municipality in general.

## Drafting the document

On 1 October 2012 was signed the Memorandum of Understanding for the Program “Local Cultural Heritage Plans 2012-2015” (LCHP) between Cultural Heritage without Borders (CHwB) and the Ministry of Culture, Youth and Sport (MCYS), the Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP), the Municipalities of Dragash, Gjakova, Gjilan, Kacanik, Partesh, Rahovec and Vushtrri. This program will contribute in strengthening the role of municipalities, NGOs and the community in the revitalization of local cultural and natural heritage and their sustainable use for local economic development goals in seven partner municipalities.

The three main goals of the Program are: 1. Protection and preservation of cultural and natural heritage; 2. The integration of cultural and natural heritage in contemporary life and local development; and 3. Education, training and raising awareness on cultural and natural heritage.

One of the main focuses of the program was the establishment of local forums in each partner municipality. Local Cultural Heritage Forum of Gjakova consisted of 20 members, with more than half of the members from the respective municipality, representatives of the central institutions, local authorities, international organizations and civil society. The four main roles of the forum were: communication and interagency coordination; decision-making body in the drafting of plans and setting priorities; monitoring and support role in implementing the priorities emerged from the plans and implementing partners on a number of priorities emerging from the plans.

In July 2013, the Local Forum completed the drafting of Local Cultural Heritage Plan (LCHP) of the Municipality of Gjakova. This plan, besides various analysis, contains over 40 priorities identified for the protection





dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Në fillim të vitit 2015, zyra e CHwB në Kosovë në bashkëpunim me partnerë të institucioneve të nivelit lokal dhe atij qendror kanë filluar së hartuari një nga prioritetet e dala nga ky Plan, strategjinë e funksionalizimit të Çarshisë së Gjakovës të titulluar me emrin “Hapësira Historike Urbane - Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë”.

Fillimi i hartimit të dokumentit lidhet me fillimin e fazës së dytë, fazës së implementimit të Planit Lokal për Trashëgimi Kulturor. Fillimisht nën udhëheqjen e CHwB-së është themeluar Grupi Punues i Profesionistëve, në të cilin u ftuan të gjitha strukturat e mundshme dhe të nevojshme për hartimin e këtij dokumenti me rëndësi për Çarshinë (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/IPH; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/DTK/QRTK Gjakovë; Komuna e Gjakovës, etj.).

Në takimin e parë të Grupit, sipas agjendës u bë prezantimi i shkurtër lidhur me përmbajtjen e projektit dhe aktivitetet në vazhdim, në funksion të hartimit të një dokumenti që do të ofrojë rekomandime të qarta për funksionalizimin e Çarshisë së Madhe. Përmbajtja e dokumentit është propozuar në bazë të hulumtimeve të praktikave të mira ndërkombëtare, rekomandimeve të dala nga forumi i PLTK-së dhe resurseve në dispozicion. Në pika të shkurtëra u njoftua se pjesë e rëndësishme e aktiviteteve do të jetë organizimi i pesë punëtorive, në një afat tentativ kohor prej pesë muajve.



and promotion of cultural and natural heritage. In early 2015, the office of CHwB in Kosovo in cooperation with partners at the local level institutions and central government began elaborating one of the priorities derived from this plan, the strategy of the regeneration of Gjakova Bazaar, titled “Historic Urban Area – the framework for the regeneration of the Great Bazaar in Gjakova”.

The start of the draft document is related to the start of the second phase, the implementation phase of the Local Cultural Heritage Plan. Initially led by CHwB, the Working Group of professionals was established, where all possible and necessary structures for the elaboration of this important document for the Bazaar were invited (the Ministry of Environment and Spatial Planning/ISP, Ministry of Culture, Youth and Sport /DCH /RCCH; Municipality of Gjakova, etc.).

At the first meeting of the Group, according to the agenda, was held a short presentation on the content of the project and ongoing activities, in order to draft a document that would provide clear recommendations for the regeneration of the Great Bazaar. The proposed content of the document is based on research of international best practices, recommendations from LCHP forum and available resources. It was briefly announced that an important part of activities will be the organization of five workshops, in a tentative time frame of five months.

Punëtorja	Tema/ Kaptina	Përmbajtja/Procesi i punes
I	<b>Njohja me projektin</b>	Njohja e pjesëmarrësve me idenë dhe hapat që duhet të ndërmerren për hartimin e dokumentit.
II	<b>Gjendja ekzistuese (Profili) dhe SWOT analiza</b>	Prezantimi i hulumtimit që është bërë lidhur me gjendjen momentale të veprimtarive në të gjithë Çarshinë. U diskutua lidhur me rezultatet e hulumtimit dhe u rekomaduan plotësimet e tij. Punëtorja u përfundua me SWOT analizën që në fakt paraqet përmbledhjen e situatës ekzistuese.
III	<b>Deklarata e Vizionit dhe përcaktimi i Qëllimeve kryesore</b>	Fillimisht para pjesëmarrësve u prezantua propozimi për deklaratën; e njëjta u diskutua, u plotësua deri në formën që ishte adekuate për të gjithë pjesëmarrësit. Pjesa e dytë e punëtorisë u muarr me nxjerrjen e qëllimeve kryesore që ishin si rrjedhojë e deklaratës. Duke pasur parasysh se kjo është baza e projektit, nga të gjithë pjesëmarrësit u kërkua që të shfrytëzohet koha deri në punëtorinë tjetër për plotësime dhe rekomandimetjera shtesë. Deklarata dhe qëllimet kryesore përfundimisht u aprovuan në fillim të punëtorisë së katërt.
IV	<b>Identifikimi i nevojave, masave veprimeve dhe projekteve</b>	Në pjesën e parë të punëtorisë u aprovua deklarata e vizionit dhe lista e qëllimeve kryesore nga punëtorja e kaluar. Në vazhdim të punëtorisë, nga secili qëllim i identifikuar u nxjerrën nevojat/masat/veprimet apo projektet që do të ndikojnë në arritjen e qëllimeve kryesore.
V	<b>Përcaktimi i prioritetëve resurseve dhe afateve</b>	Punëtorja e fundit, në të cilën u përmbledhën të gjitha rezultatet e deritashme; u nxorren prioritetet; u identifikuan resurset; dhe u përcaktuan afatet dhe përgjegjësitë. Në fund të takimit u prezantuan hapat deri në përmbylljen e projektit.

**Tabela 1** - Ndarja e punëtorive sipas kaptinave të dokumentit dhe përbërja e tyre – Procesi i punës

Sipas skemës së prezantuar, materialet e dalura nga secila punëtori bashkë me hulumtimet përcjellëse do të shërbejnë si bazë për hartimin e kaptinave të propozuara të dokumentit. Në fund të takimit të parë, përmes diskutimeve dhe punës individuale nga secili anëtar i grupit punues, është identifikuar lista e çështjeve kryesore të përmbledhura në disa fusha tematike në kuadër të sfidave të përmendura.

Workshop	Topic/ Chapter	Content/ Working process
I	<b>Knowing the project</b>	Introduce participants to the idea and steps to be taken to prepare the document.
II	<b>Existing condition (Profile) and SWOT analysis</b>	Presentation of the research on the current state of activities throughout the Bazaar. It discussed the results of the research and its amendments were recommended. The workshop was concluded with SWOT analysis that actually presents a summary of the current situation.
III	<b>The Statement of Vision and the determination of the main goals</b>	Initially, the participants were presented the proposal for the statement; The same was discussed, supplemented to the adequate form for all participants. The second part of the workshop dealt with the issuance of the main goals, which were as a result of the statement. Given that this is the basis of the project, all participants were asked to use the time until the next workshop for other additional recommendations and amendments. The declaration and main goals are approved at the beginning of the fourth workshop.
IV	<b>Identification of needs, actions, measures and projects</b>	In the first part of the workshop were adopted the statement of the vision and a list of the main goals of the last workshop. Following the workshop, from each identified goal were issued needs/ measures/ actions or projects that will impact the achievement of key goals.
V	<b>Setting of priorities, resources and deadlines</b>	The last workshop, which summarized all results so far issued the priorities, identified the resources and defined deadlines and responsibilities. At the end of the meeting were presented the steps until the conclusion of the project.

**Table 1** – The distribution of workshops according to document chapters and their composition - the working process

According to the presented scheme, the materials derived from each workshop with accompanying research will serve as a basis for drafting the proposed chapters of the document. At the end of the first meeting, through discussions and individual work of each member of the working group, was identified a list of key issues outlined in the thematic areas within the mentioned challenges.



Sfidat Hapësinore		Sfidat Menaxheriale	
Infrastruktura	Hyrje - daljet në Çarshi të Madhe Asetet specifike publike Ndërtimet ilegale Infrastruktura nëntokësore Shenjzimi, ndriçimi, mbeturinat, parkingjet etj.	Aspekti zhvillimor Qeverisja	Raporti i fizibilitetit për zgjidhjet e qëndrueshme të funksionalizimit Përcaktimi i modeleve dhe studimi i fizibilitetit Zhvillimi VS konservimi Përpilimi i informatorit (trashëgimi kulturor, turizëm) Integrimi i artizanateve
Mobiliteti	Lëvizshmëria - automjetet, biçikletat dhe këmbësorët Sigurimi i hapësirave për parkim Kategorizimi i infrastrukturës rrugore	Ngritja e kapaciteteve njerëzore	Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e TK-së Trajnimet Qasja e integruar Shembuj/raste studimi
Zonimi	Përcaktimi i kufirit të zonës Përcaktimi i zonave muzeale Përcaktimi i zonave mbrojtëse (bufër) Përcaktimi i zonave funksionale Krijimi i hapësirave publike / gjelbërimi;	Bashkëpunimi institucional	Plotësimi i bazës ligjore me Udhëzimet Administrative Qartësimi i përgjegjësive (Komuna – Ministria) Bashkërendimi me institucionet tjera Pagesa mujore për artizanatet Subvencionet Percaktimi i Produkteve turistike
Udhëzues	Udhëzuesit për ndërtime të reja Parandalimi i degradimeve	Aspekti organizativ	Krijimi i Këshilit për mirëmbajtjen e TK-së Menaxhimi i parkingjeve Menaxhimi i turizmit (trashëgimia kulturor) Themelimi i zyrës menaxhuese Menaxhimi me asete komunale Vendimmarrja për veprimet në Çarshi Diversifikimi i veprimtarive Shpërndarja e bizneseve Kordinimi mes akterëve
Dendësia	Rritja e prurjeve njerëzore		

**Tabela 2 - Sfidat dhe problemet e identifikuar**

Spatial challenges		Managing challenges	
Infrastructure	Entry - exit in the Grand Bazaar Specific public assets Illegal construction Underground infrastructure Signage, lighting, litter, parking etc.	Developing aspect Governing	The feasibility report on the sustainable solutions of regeneration Defining models and feasibility study Development VS conservation Compilation of the informant (cultural heritage, tourism) Integrating crafts
Mobility	Mobility - vehicles, bicycles and pedestrians Provide parking spaces Categorization of road infrastructure	Human capacity building	Raising awareness about the protection of CH Trainings Integrated approach Examples/ case studies
Zoning	Defining the boundary of the area Determining the museum areas Determining protective zones (buffer zones) Determining the functional areas Creating public spaces/ greenery;	Institutional collaboration	Completing the legal basis with Administrative Instructions Clarifying the responsibilities (Municipality - Ministry) Coordination with other institutions The monthly payment for handicrafts Subsidies Determination of tourist products
Guidelines	Guidelines for new buildings Preventing the degradation	Organizational aspect	Creating the Council for CH maintenance Managing parking Managing tourism (cultural heritage) Founding the management office Managing municipal assets Decision on actions in Bazaar Activities diversification Distributing businesses Coordinating actors
Density	Increased human flows		

**Table 2 - Challenges and identified problems**

## Gjendja ekzistuese

Në vazhdim të punës për hartimin e dokumentit është organizuar një hulumtim i shkurtër, lidhur me gjendjen ekzistuese në zonën e Çarshisë sipas kufirit të përcaktuar në dokumentin “Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë”, dhjetor 1979 dhe Vendimin për planin e rregullimit të “Çarshisë së Madhe” në Gjakovë, qershor 1982 në G.Z. 25/82.



**Fig.1** –Kufiri i Çarshisë së Madhe të Gjakovës

## The existing situation


In the ongoing work for the elaboration of the document, was organized a brief research regarding the existing situation of the Bazaar area according to the border defined in the document “Study of regeneration and revitalization of the Grand Bazaar in Gjakova” in December 1979 and a decision on the Regulative Plan “Great Bazaar” in Gjakova, in June 1982 in G.Z. 25/82.



**Fig.1** – The border of Old Bazaar




Analiza fillestare u realizua lidhur me destinimin e objekteve në kuadër të zonës së Çarshisë, sipas të cilës pjesa më e madhe janë objekte banimi (ngjyra e kuqe), të shpërndara në të gjithë sipërfaqen e Çarshisë. Dyqanet dhe objektet tjera afariste tregtare janë destinimi i radhës (me ngjyrë të verdhë) të cilat shtrihen përgjatë rrugëve kryesore të Çarshisë, dhe objektet tjera me rëndësi janë objektet publike (me ngjyrë të kaltër), të cilat janë në disa pjesë të zonës.





**Fig.2 - Destinimi i objekteve në zonën e Çarshisë**

The initial analysis was conducted about the designation of buildings within the area of the Bazaar, most of them being residential (red color), spread across the whole area of the bazaar. Commercial shops and other commercial buildings are the next designation (yellow), which extend along the main streets of the bazaar, and other important buildings are public ones (blue), which are in some parts of the area.





**Fig.2 - The designation of buildings in the Bazaar area**

Qëllimi kryesor i hulumtimit lidhet me shfrytëzimin aktual të dyqaneve që ndodhen në rrugët kryesore të Çarshisë, që në fakt paraqesin pjesën më të rëndësishme të saj. Sipas kësaj analize, shumica e dyqaneve nga 436 (525 ka e gjithë zona) që ndodhen në Rrugën “Ismail Qemali” duke përfshirë edhe Lamën e Drithit, Rrugën e Jorganxhinjëve, Rrugën “Abedi Terbeshi” dhe Rrugën e Kutijgjinjve janë të mbyllura 146 lokale, 34 prej tyre janë me funksion aktual kafiteri, ndërsa në pjesën tjetër të mbetur të lokaleve veprimtaria më e shpeshtë është tregtia (kryesisht tregti me tekstil).



**Fig.3** - Grafiku i shfrytëzimit dhe statusi aktual i lokaleve në rrugët kryesore të zonës së Çarshisë

The main purpose of the research is related to the actual use of shops located in the main streets of the bazaar that in fact represent the most important part of it. According to this analysis, most of the stores, from 436 (the whole area has 525) located in the street “Ismail Qemali “ including Lama e Drithit, Jorganxhi street, “Abedi Terbeshi” and Kutijgjinj street, 146 shops are closed, 34 of them are bars, while in the remainder of the shops the most common activity is trade (mainly textiles trade).



**Fig.3** - Graph of use and current status of the shops on the main streets of the bazaar area






**Fig.4 - Shfrytëzimi aktual i dyqaneve në rrugët kryesore të Çarshisë**

Të dhënat për shfrytëzimin aktual të objekteve, dyqaneve të Çarshisë, dallojnë nga shfrytëzimi fillestar i tyre. Sipas rezultateve të hulumtimit, destinimi dhe shfrytëzimi i objekteve deri më sot ka pësuar ndryshime të shpeshta në një pjesë të konsiderueshme të tyre. Pjesë e analizës ka qenë edhe përpjekja për të zbuluar destinimin fillestar të objekteve/dyqaneve, e cila mund të shihet në figurën e mësipërme. Sipas kësaj analize në kuadër të objekteve-dyqaneve janë zhvilluar veprimtaritë si: Rrobaqepës, Jorganxhinjë, Zhgunpunues, Filigran/Argjendar, Qulaxhinjë, Këpucëtar, Teneqepunues, Sahatçi, etj. të cilat ishin të vendosura në Çarshi sipas figurës së mëposhtme.




**Fig.4 - Current use of shops in the main streets of the Bazaar**

The data on the actual use of buildings and shops of Bazaar differ from their initial use. According to the survey results, the designation and use of buildings until today have undergone frequent changes in a substantial part of them. Part of the analysis has been the attempt to discover the initial designation of buildings/ shops, which can be seen in the figure above. According to this analysis, within-shop buildings were developed the following activities: Tailors, Quilt smiths, Filigree/ Silversmiths, hatmaker, Shoemakers, Tinsmiths, Watchmakers, etc. located in the Bazaar, according to the picture below.



**Fig.5 - Destinimi/shfrytëzimi fillestar i objekteve/dyqaneve**



**Fig.5- Designation / initial use of buildings / shops**



NR.	VEPRIMTARIA AKTUALE	VEPRIMTARIA FILLESTARE
...		
274	E MBYLLUR	GJELLTORRE
289	RROBAÇEPËSI	KAFETERI
290	E MBYLLUR	
291	E MBYLLUR	JORGANGXHI
292	USHQIMORE	JORGANGXHI
293	PTK	
294	E MBYLLUR	KAFETERI
295	SERVIS I TELEFONAVE	PËRPUNIM I DRITHIT
296	SERVIS I TELEFONAVE	PËRPUNIM I DRITHIT
297	E MBYLLUR	
...		

**Tab.3** - Një pjesë nga analiza e zhvilluar në terren

Opinion i përgjithshëm që u fitua nga biseda dhe diskutimi me një pjesë të pronarëve është se, ndryshimi i shpeshtë i destinimit dhe shfrytëzimit të dyqaneve ka ndodhë si pasojë e përpjekjes për tu përshtatur me ndryshimet politike dhe ekonomike të kohës. Kjo është edhe arsyeja kryesore e zhdukjes së një pjese të madhe të zejeve, që dikur mbanin barrën kryesore të zhvillimit të zonës. Argument tjetër me ndikim serioz në humbjen e funksionit themelor të Çarshisë është edhe menaxhimi, i cili praktikisht në zonën e Çarshisë ka munguar. Shoqata aktuale e zejtarëve e themeluar për të mbrojtur interesat e zejtarëve dhe për të ofruar ndihmën e nevojshme, ishte dhe vazhdon të jetë e pafuqishme dhe pa përkrahjen e duhur.

Për të pasur pasqyrë më të qartë të gjendjes aktuale është zhvilluar analiza SWOT, me të cilën në detaje janë analizuar faktorët me ndikim.

NR.	CURRENT ACTIVITY	INITIAL ACITIVITY
...		
274	CLOSED	RESTAURANT
289	TAILORING	CAFE
290	CLOSED	
291	CLOSED	QUILTSMITH
292	GROCERY	QUILTSMITH
293	PTK	
294	CLOSED	CAFE
295	PHONE SERVICE	GRAIN PROCESSING
296	PHONE SERVICE	GRAIN PROCESSING
297	CLOSED	
...		

**Tab.3** - A part of the analysis developed in the field

The general opinion gotten by the conversation and discussion with some of the owners, is that frequent changes of designation and use of stores occurred as a result of the effort to adapt to economic and political changes of the time. This is the main reason of the disappearance of a large part of crafts, formerly bore the main burden of the development of the area. Another argument with serious impact on the loss of basic function is the management of the Bazaar, which practically lacked in the area. The current association of craftsmen, established to protect the interests of artisans and to provide the necessary assistance, was and continues to be weak and without adequate support.

The SWOT analysis was done to have a clear overview of the actual state, which analyzed thoroughly the influential factors.

## Analiza SWOT

### (S) PËRPARËSITË (faktorët e brendshëm pozitiv)

#### - Trashëgimi kulturore me vlerë

I gjithë kompleksi paraqet bërthamën historike të qytetit e cila me unitetin arkitektonik dhe me cilësitë e mbetura, ka vlerë të pamohueshme kulturore, artistike dhe historike dhe si e tillë është pjesë e listës së përkohshme të objekteve nën mbrojtje të përhkohshme, të nxjerrë nga MKRS;

#### - Pozitë e mirë hapësinore

Në raport me zonën urbane të qytetit, lokacioni i Çarshisë ka një pozitë të mirë, në afërsi me qendrën e qytetit dhe zonat natyrore: Shkugëza dhe Çabrati. Ndërsa, në aspektin rajonal, pozita e kompleksit të Çarshisë është gjithashtu e favorshme, duke qenë në mesin e disa pikave turistike (Prizreni, Mirusha, Maja e Gjeravices, Liqeni i Radoniqi-t, Aeroporti i Gjakovës, Valbona (Shqipëri), etj.)

#### - Qasja e lehtë

I gjithë lokacioni është i rrethuar me disa hyrje të niveleve të ndryshme, të cilat e lehtësojnë qasjen e të gjitha formave në kompleks;

#### - Afërsia e drejtpërdrejtë me lumin Krena dhe Çabratin

Zona natyrore / rekreative;

#### - Gjendja fizike relativisht e mirë objekteve

Në aspektin fizik, pjesa më e madhe e strukturave, objekteve është në gjendje relativisht të mirë;

#### - Pronat komunale në kuadër të zonës

21 objekte janë në pronësi të komunës;

#### - Ekzistenca e infrastrukturës teknike

Rrjeti i energjisë elektrike, ujësjellësit, kanalizimit, telefonia, etj.;

#### -Kapacitete humane të mjaftueshme

Në bazë të informatave komuna e Gjakovës disponon me numër të konsiderueshëm të kapaciteteve humane profesionale;

## SWOT Analysis

### (S) OPPORTUNITIES (positive internal factors)

#### - Significant cultural heritage

The entire complex represents the historical core of the city, which with the architectural unity and outstanding qualities, has undeniable cultural, artistic and historical values, and as such is part of the Cultural Heritage List under temporary protection, issued by MCYS;

#### - Good spatial position

In relation to the urban area, the location of Bazaar has a good position, close to the center of the city and natural areas: Shkugëza and Çabrati. Meanwhile, in regional terms, the position of Bazaar complex is also favorable, being among the few touristic spots (Prizren, Mirusha, Valbona, Gjeravica Peak, Radoniqi Lake, Gjakova airport, etc.)

#### - Easy access

The whole site is surrounded by several different entry levels, which facilitate the access of all forms in the complex;

#### - Direct proximity to the river Krena and Çabrati

Natural/ recreation area;

#### - Relatively good physical condition of buildings

In physical terms, most of structures and buildings are in relatively good condition;

#### - Municipal properties within the area

21 municipal owned buildings;

#### - The existence of technical infrastructure

Electricity network, water supply, sewage, telephones, etc.;

#### - Sufficient human capacities

According to the available information, the municipality of Gjakova has a significant number of professional human capacities;





**- Dokumentacion i bollshëm ekzistues**

Sa i përket të dhënave, ekziston një sasi e konsiderueshme e dokumenteve dhe informatave të ndryshme lidhur me zhvillimin e Çarshisë, që e lehtëson procesin në përgjithësi;

**- Kufiri i përcaktuar i zonës**

Zona e Çarshisë së Madhe ka kufij të përcaktuar që mundëson aplikimin e masave specifike administrative;

**- Interesimi dhe entuziazmi i lartë**

Aktualisht vërehet një përkushtim i lartë nga të gjithë pjesëmarrësit pa dallim, për adresimin e funksionalizimit të Çarshisë dhe të ardhmen e saj;

**- Identiteti i qytetit**

Vlerat historike, kulturore dhe ambientale të Çarshisë së Madhe, krijojnë një 'sens' të fuqishëm të vendit, dhe një mjedis atraktiv për kalimtarët dhe vizitorët;

**- Sufficient existing documentation**

Regarding the data, there is a considerable amount of various documents and information related to the development of the bazaar, which facilitate the overall process;

**- Defined border of the area**

The Great Bazaar area has defined borders that enables the application of specific administrative measures;

**- High interest and enthusiasm**

Currently there is a high commitment from all participants without differences, to address the regeneration of the Bazaar and its future;

**- Identity of the city**

Historical, cultural and environmental values of the Grand Bazaar, create a strong 'sense' of the country and an attractive environment for pedestrians and visitors;



**(W) DOBËSITË** (faktorët e brendshëm negativ)**- Mungesa e një organi menaxhues**

Kompleksi i Çarshisë së Madhe të Gjakovës duhet ta ketë një trup menaxhues, që do të merret me të gjitha çështjet që ndërlidhen me funksionimin e Çarshisë. Mungesa e tij është njëri nga shkaktarët kryesorë të zhvillimit jo adekuat të shumë projekteve që janë realizuar deri më tash në kuadër të Çarshisë;

**- Mosrespektimi i ligjit**

Shkelja e kushteve të ndërtimit, përdorimi i materialeve joadekuate, etj;

**- Komunikimi dhe lëvizshmëria jo adekuate**

Rrjeti ekzistues i rrugëve të niveleve të ndryshme në shumë raste bëhet pengesë e komunikimit, lëvizjes së drejtë;

**- Infrastruktura teknike**

Me probleme dhe ende jashtë funksionit të duhur;

**- Shërbimet publike**

Mbledhja e mbeturinave në nivel jo të kënaqshëm; mungesa e ndriçimit publik;

**- Mungesa e shenjave dhe informacioneve**

Në të gjithë lokacionin ka shumë pak shenja dhe informacione, që duhet të ndihmojnë për orientim të drejtë dhe prezantimin e duhur të Çarshisë;

**- Disa nga dyqanet ende të pa rindërtuara**

Janë 60 lokale ende të pa rindërtuara, të cilat ndikojnë negativisht në pamjen e përgjithshme të Çarshisë;

**- Disa nga dyqanet jo aktive**

Lokalet e pashfrytëzuara i japin imazh jo të mirë Çarshisë;

**- Veprimtaria joadekuate e disa dyqaneve**

Koncentrimi aktual i kafiterive;

**- Materialet promovuese të pamjaftueshme**

Materialet promovuese për pozitën dhe vlerat historike për Çarshinë, janë të limituara;

**- Mungesa e investimeve****- Mungesa e sigurisë**

Qarkullimi i ulët në orët e mbrëmjes, mungesa e patrullimit policor;

**(W) WEAKNESSES** (negative internal factors)**- The lack of a managing body**

The Grand Bazaar complex of Gjakova must have a managing body, which will deal with all issues related to the functioning of the bazaar. Its absence is one of the main causes of inadequate development of many projects that have been implemented so far within the Bazaar;

**- Violation of Law**

Violation in terms of construction, the use of inappropriate materials, etc;

**- Inadequate communication and mobility**

The existing network of routes at different levels, in many cases becomes an obstacle of communication, proper mobility;

**- Technical Infrastructure**

With problems and still out of a proper function;

**- Utilities**

Litter collection is unsatisfactory; lack of public lighting;

**- Lack of signs and information**

In every site there is little evidence and information about proper orientation and presentation of the bazaar;

**- Some stores still not reconstructed**

60 stores are not yet reconstructed, which adversely affect the appearance of the Bazaar;

**- Some of the stores inactive**

Unused shops do not give a good image of the Bazaar;

**- Inadequate activity of several shops**

The current concentration of cafes;

**- Inadequate promotional materials**

Promotional materials for the position and historical values of Bazaar are limited;

**- Lack of investment****- Lack of security**

Low turnover in the evening, lack of police patrol;



**(O) MUNDËSITË** (faktorët e jashtëm pozitiv)**- Përfshirja e Çarshisë në itineraret turistike rajonale**

Është shumë e mundshme që Çarshia me përmbajtjet e saja të bëhet pjesë e rrjetit rajonal turistik. Me pak përkushtim, një vlerë e tillë mund të bëhet pjesë e programeve të kompanive të ndryshme turistike vendore dhe rajonale;

**- Rritja e interesimit për vizita**

Sipas trendit aktual të zhvillimit të turizmit, turizmi kulturor (trashëgimia kulturore dhe natyrore) vlerësohet si kategori me rritje të lartë të interesimit të vizitorëve;

**- Brendimi**

Promovimi i përbashkët i disa produkteve ofertës kulturore (shpirtërore, gastronomike,...), p.sh. “Ditët e Çarshisë së Madhe” etj.

**- Programe dhe fonde të ndryshme për trashëgimi kulturore**

Mbrojtja dhe ruajtja e TK është në fokus të disa programeve dhe projekteve ndërkombëtare. Një projekt i qartë për revitalizim, me kërkesa dhe hapa të qartë të aktiviteteve, shumë lehtë mund të bëhet pjesë e këtyre programeve dhe të përfitojë nga këto fonde me interes për Çarshinë;

**- Interesimi i lartë i komunitetit ndërkombëtar**

Trashëgimia kulturore dhe natyrore është në agjendën e përhershme të komunitetit ndërkombëtar. Të gjitha rekomandimet e tyre lidhen me ruajtjen dhe trajtimin me prioritet të çështjes së trashëgimisë kulturore;

**- Përfshirja e shërbimeve tjera**

Është rast i mirë dhe mundësi e lehtë që disa shërbime komunale (pagesa e tatimit në pronë, etj.) por edhe të tjera (banka, posta, uji, mbeturinat, etj.) të jenë pjesë përbërëse e Çarshisë, të cilat ndikojnë në shtimin e numrit të vizitorëve;

**- Përfshirja e zonës në EUROPAN Kosova**

Është rast i mirë që përvoja dhe propozimet që dalin nga ky projekt të ndikojnë pozitivisht edhe në projektin tonë;

**(O) OPPORTUNITIES** (external positive factors)**- The involvement of bazaar in the regional touristic itineraries**

It is highly probable that the Bazaar with its contents to become part of the regional tourism network. With a little dedication, such a value can be part of programs of different local and regional touristic companies;

**- Increased interest in visits**

According to the current trend of tourism development, cultural tourism (cultural and natural heritage) is estimated as high-growth category of interest of visitors;

**- Branding**

Joint promotion of some products of cultural offer (spiritual, gastronomic ...), e.g. “The Great Days of the Bazaar” etc.

**- Various programs and funds for cultural heritage**

The protection and preservation of CH is the focus of several programs and international projects. A clear project for revitalization, with clear requirements and steps of activities, could easily become part of these programs and to benefit from these funds of interest for the Bazaar;

**- High interest of the international community**

Cultural and natural heritage is permanently on the agenda of the international community. All recommendations related to preservation and treatment of cultural heritage is a priority;

**- Include other services**

It is a bargain and an easy option that some municipal services (payment of property tax, etc.) but also other (bank, post, water, waste, etc.) to be part of the bazaar, which impact the increase of the number of visitors;

**- The inclusion of the area in EUROPEAN Kosovo**

It is a good opportunity that the experience and proposals arising from this project will impact positively in our project;

**(T) RREZIQET** (faktorët e jashtëm negativ)**- Ndryshimet politike**

Ndryshimi i agjendave politike lokale mund të paraqesin pengesa në implementimin e ideve që do të propozohen nga projekti;

**- Buxheti i pamjaftueshëm**

Duke iu referuar të dhënave aktuale, buxheti për trashëgimi kulturore është shumë i ulët, i cili mund të ndikojë në kufizimin e aktiviteteve që do të parashihen me projekt;

**- Pikat tjera turistike më të rëndësishme**

Duke qenë se Çarshia është në mesin e disa pikave tjera të vlefshme turistike, të cilat në raport me Çarshinë janë më të njohura, kanë një prezantim dhe përfaqësim më të fuqishëm, është shumë e pritshme që një trend i tillë të vazhdoj edhe më tutje;

**- Përkrahja e pamjaftueshme institucionale**

Njëri nga faktorët kryesorë për degradimin e vazhdueshëm të trashëgimisë kulturore është edhe përkrahja jo e mjaftueshme materiale e institucioneve përgjegjëse për ruajtjen e saj (restaurimi i objekteve, stimulimi i zejeve në zhdukje,.);

**- Zhdukja e zanateve**

Në bazë të të dhënave ekzistuese, janë një numër i konsiderueshëm i zanateve në Çarshi, të cilat janë zhdukur ose janë në proces të zhdukjes;

**(T) RISKS** (negative external factors)**- Political changes**

The change of local political agendas could pose obstacles to the implementation of ideas that will be proposed by the project;

**- Insufficient budget**

Referring to current data, the budget for cultural heritage is very low, which can affect the limitation of activities that will be determined in the project;

**- Other more important touristic places**

Because Bazaar is among other several valuable touristic places, which in relation to the Bazaar are more popular by also having a more powerful presentation and representation, it is expected that such a trend to continue further;

**- Insufficient institutional support**

One of the key factors for the continuing degradation of the cultural heritage, is insufficient material to support the institutions responsible for its preservation (restoration of buildings, stimulating crafts in extinction);

**- Extinction of crafts**

Based on the existing data, there are a considerable number of crafts in Bazaar, which are missing or are in the process of extinction;





**- Ruajtja e karakterit burimor**

Tregëti, zejтари dhe shërbime tjera burimore;

**- Hapja e qendrave tjera tregtare**

Është faktor tjetër i cili ndikon në rënien e interesimit për shërbimet në Çarshi;

**- Kosto e lartë e mirëmbajtjes**

**Konkludim** - Përmbledhja e gjendjes ekzistuese ka vënë në pah se çështjet kyçe dhe mundësitë kryesore të funksionalizimit të Çarshisë ndërlidhen me:

- Mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të TK
- Aspektin organizativ të zhvillimit/menaxhimit të trashëgimisë
- Gjenerimin e përfitimit ekonomik
- Zonimin
- Lëvizshmërinë/trafikun
- Hapësirat publike dhe infrastrukturën përcjellëse

Çarshia e Madhe me vlerat e saj të trashëgimisë ka potencial të pamohueshëm për zhvillim. Megjithatë, përkundër investimeve që janë bërë në tentim të revitalizimit të saj, ende nevojiten ndryshime dhe investime të cilat do ta shndërronin atë në një komunitet funksional.

Me karakterin e saj tradicional si qendër e zejeve, tregtisë dhe shërbimeve dhe afërsinë e drejtpërdrejtë me qendrën e re të qytetit, Çarshia e Madhe ofron mundësi për vendosjen e veprimtarive për biznes, tregti, administratë dhe kulturë si dhe banim në lagjet që e rrethojnë. I një rëndësie të veçantë është zhvillimi i turizmit kulturor, që do të stimulojnë zhvillimin e veprimtarive shërbyese (kafiteri, restorante, bujtina,...) të cilat poashtu do të jenë në funksion të jetës shoqërore në qytet. Rizhvillimi i zonave të banimit në kufijtë e çarshisë do të krijonte një energji të re dhe do të mbi-ndërtonte strukturën urbane që është jetike për një komunitet vital.

**- Maintaining the original character**

Trade, crafts and other resource services;

**- Opening of other shopping centers**

Another factor that affects the decline of interest in Bazaar services;

**- High cost of maintenance**

**Conclusion** – The summary of the current situation has highlighted that the key issues and opportunities of the regeneration of Bazaar are related to:

- Protection and preservation of CH
- Organizational aspect of development/ heritage management
- Generating economic incomes
- Zoning
- Mobility/ traffic
- Public spaces and associated infrastructure

The Grand Bazaar with its heritage values has undeniable potential for development. However, despite the investments made in its revitalization attempt, changes and investments that will transform it into a functional community are still needed.

With its traditional character as a center of crafts, trade and services and direct proximity with the new center of the city, the Grand Bazaar offers the opportunity to establish business, trade, administration and culture activities and housing in the surrounding neighborhoods. Of a particular importance is the development of cultural tourism, which will stimulate the development of service activities (bars, restaurants, hostels...), which will also serve to the social life in the city. Redevelopment of residential areas on the borders of the bazaar will create a new energy and over-build urban structure that is vital to a vital community.

**III. VIZIONI, PARIMET  
DHE SYNIMET KRYESORE**

**III. VISION, PRINCIPLES  
AND MAIN GOALS**





**D**eklarata e Vizionit “Çarshia e Madhe 2020” prezanton dëshirën dhe idetë e të gjithë pjesëmarrësve për funksionalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Çarshisë së Madhe të Gjakovës:

“Çarshia e Madhe, destinacion tërheqës për vizitorë, në të cilin ruhen dhe promovohen vlerat e trashëgimisë kulturore dhe mbahet gjallë tradita. Vend ku gërshetohen zejjet e vjetra, bizneset kreative, shitoret atraktive dhe aktivitetet kulturore e argëtuese, në një ambient unik të arkitekturës tradicionale i cili ofron eksperiencë të paharruara për vizitorët dhe një vend atraktiv për të punuar dhe jetuar.”

Vizioni ka për qëllim të shërbejë si udhërrëfyes për funksionalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Çarshisë së Madhe Gjakovës. Ai është ndërtuar mbi parimet, synimet kryesore të artikuluara nga ana e Grupit punues profesional dhe Grupit Këshillues të Komunitetit i cili ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në proces :

- Çdo zhvillim i ri në Çarshinë e Madhe duhet të bëhet në pajtim me ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë historike;
- Duhet të përkrahët dhe fuqizohet një autoritet menaxhues qendror;
- Duhet të sigurohet qëndrueshmëria ekonomike. Investimet e ardhshme të Çarshisë së Madhe duhet të bazohen në një strategji të shëndoshë ekonomike që do të rrisë vlerën e pronave dhe bizneseve në zonë;
- Duhet të nxitet diversifikimi i aktiviteteve me qëllim të krijohet një qarkullim i vazhdueshëm gjatë tërë kohës;
- Duhet dhënë përparësi lëvizjes së këmbësorëve në veçanti në zonën e bërthamës, përderisa trafiku i makinave duhet të planifikohet dhe drejtohet me kujdes;
- Zhvillimi i Çarshisë së Madhe duhet të vazhdojë të mbindërtohet në trashëgiminë kulturore dhe historike duke mbajtur në balans diversitetin e aktiviteteve që zhvillohen dhe të sigurohet që mos të ketë dominim të veprimtarive të caktuara në dëm të veprimtarive tjera;
- Zonimi – Bashkëjetesa e trashëgimisë kulturore me veprimtaritë tjera në zonë duhet të orientohet më tepër në drejtim të një menaxhimi adekuat kundrejt kufizimeve arbitrare të zhvillimit.

Në thelb, këto parime theksojnë nevojën për ndryshim të trendit aktual të funksionimit të Çarshisë së Madhe dhe të promovimit të një zhvillimi më dinamik të bazuar në tri komponentë kryesore të zhvillimit deri në vitin 2020:

**V**ision statement “Great Bazaar 2020” presents the desire and ideas of all participants for a sustainable development and regeneration of the Great Bazaar in Gjakova:

“The Great Bazaar, an attractive destination for visitors, where cultural heritage values are preserved and promoted and tradition is kept alive. A place where old crafts, creative businesses, attractive shops and cultural and recreational activities are intertwined, in a unique environment of traditional architecture, which provides unforgettable experiences for visitors and an attractive place to work and live.”

The vision intends to serve as a guide for the sustainable development and regeneration of the Great Bazaar in Gjakova. It is built on the principles and major goals articulated by the Professional Working Group and the Community Advisory Group, which has been actively involved in the process:

- Any new development in the Great Bazaar should be done in accordance with the preservation and protection of historical heritage values;
- A central managing authority should be supported and empowered;
- Economic sustainability must be ensured. Future investments in the Grand Bazaar must be based on a sound economic strategy that will increase the value of properties and businesses in the area;
- Diversification of activities must be stimulated in order to create a continuous flow all the time;
- Priority should be given to the pedestrian movement particularly in the core area, while vehicle traffic must be carefully planned and managed;
- The development of the Great Bazaar should continue to upgrade cultural and historical heritage by keeping in balance the diversity of activities that take place and ensuring that there will not be certain activities dominating other ones;
- Zoning - Coexistence of cultural heritage with other activities in the area should be oriented more towards an adequate management against arbitrary restrictions of development.

In essence, these principles emphasize the need to change the current trend of the operation of the Great Bazaar and the promotion of a more dynamic development, based on three main components of development by 2020:

### A. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

Deri në vitin 2020 – Çarshia do të ketë në funksion të plotë njësinë e vet përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha zhvillimeve, e aftë për ndërhyrje të duhura në përputhje me kërkesat e kohës. E përkrahur nga niveli qendror dhe lokal i administratës dhe donacioneve, do të jetë e gatshme të mbulojë të gjitha kërkesat duke përfshirë edhe ndihmën në ruajtjen dhe kultivimin e zejeve autoktone. Kjo njësi do të jetë shtytëse dhe promotori bashkëpunimit në mes të të gjithë pjesëmarrësve, duke përfshirë zejtarët, pronarët, banorët dhe strukturat përkatëse publike.

### B. TRASHËGIMIA KULTURORE, TURIZMI DHE KOMUNIKIMI

Çarshia e Madhe e Gjakovës, bërthama historike e qytetit, një zonë me vlera unike të trashëgimisë kulturore, e ndodhur në mesin e disa atraksioneve turistike natyrore, në vitin 2020 do të bëhet njëra ndër pikat kryesore të turizmit, e njohur edhe përtej kufijve të vendit.

Mikpritja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore do të jenë përgjegjësi dhe krenari që do të vazhdojë të kultivohet ndër breza nga të gjithë qytetarët. Do të jetë vend me informacione të mjaftueshme të cilat komunikojnë rëndësinë historike të çarshisë me shkallën, proporcionet e saja karakteristike. Çarshia e Madhe do të jetë adresa kryesore e takimeve për të gjithë qytetarët pa dallim, dhe destinacion i vizitorëve, turistëve ku përmes programeve të ndryshme të vizitave do të përjetohen vlerat unike historike dhe kulturore të saj.

Çarshia e Madhe me përmbajtjet e veta, do të jetë gjeneratori kryesor i zhvillimit për komunën, e cila me sukses do të garojë me të gjitha pikat tjera turistike të rajonit për rritjen e vazhdueshme të numrit të vizitorëve vendor dhe të huaj.

### C. LËVIZSHMËRIA DHE HAPËSIRA

Çarshia e Madhe në vitin 2020 do të jetë qendër e komunitetit, në të cilin përparësi absolute do t'i jepet këmbësorit, lëvizjes së tij të papenguar dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për tregti, zeje, administratë, afarizëm, socializim. Do të jetë vend i sigurt, me hapësira publike të rregulluara mirë dhe të mirëmbajtura, me qasje të lehtë për të gjithë pjesëmarrësit duke i përfshirë edhe lëvizjet e papenguar të mjeteve motorike. Në kuadër të Çarshisë do të përcaktohen zonat funksionale sipas kriterëve të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të cilat do të ndikojnë në ruajtjen dhe përjetimin e kësaj vlere unike. Me këtë nuk synohet transformim radikal i zonës së Çarshisë së Madhe, por më tepër ndërmarrja e disa veprimeve korrigjuese kundrejt disa çështjeve të cilat janë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të saj në përmbushjen e nevojave dhe funksioneve të qytetit modern, duke i njohur dhe mbrojtur vlerat e pasura të trashëgimisë kulturore.

### A. ORGANIZATION AND MANAGEMENT

By 2020 – The Bazaar will be in full view of its unit, responsible for managing all development, capable of appropriate interventions in accordance with the requirements of the time. The support from the central and local administration and donations will be ready to cover all requirements, including assistance in the preservation and cultivation of vernacular crafts. This unit will be driving and promoting the cooperation between all participants, including artisans, owners, residents and concerned public structures.

### B. CULTURAL HERITAGE, TOURISM AND COMMUNICATION

The Great Bazaar of Gjakova, the historic core of the city, an area with unique values of cultural heritage, situated among several natural tourist attractions, will be one of the highlights of tourism in 2020, well known beyond the country's borders.

Hospitality, preservation and promotion of cultural heritage will be the responsibility and pride that will continue to be cultivated over generations of all citizens. It will be a place with enough information that communicates the historical significance of bazaar with its scale and characteristic proportions. The Great Bazaar will be the main address of meetings for all citizens without differences, and a destination of visitors and tourists, where through various visiting programs, the unique historical and cultural heritage will be experienced. The Grand Bazaar with its contents will be the main driver of development for the municipality, which will compete successfully with all other touristic places of the region for a continued growth in the number of local and foreign visitors.

### C. MOBILITY AND SPACE

In 2020, the Grand Bazaar will be the center of the community, in which absolute priority will be given to pedestrians, their movement and unhindered delivery of services needed for trade, craft, administration, business and socializing. It will be a safe, well-regulated and well maintained public space, with easy access for all participants including unhindered motor vehicle mobility. Within the Bazaar, functional areas will be determined, according to the criteria for the protection of cultural heritage, which will impact the preservation and experience of this unique value.

A radical transformation is not intended in the Great Bazaar area, but rather to undertake some corrective actions against certain issues, which are obstacles of further development in meeting the needs and functions of the modern city, by recognizing and protecting the rich values of cultural heritage.



## **IV. KORNIZA STRATEGJIKE E FUNKSIONALIZIMIT**

*Synimet e shprehura bashkë me objektivat/veprimet e përcaktuara kanë krijuar një koncept të përgjithshëm për vizionin dhe përmbajtjen e kornizës për funksionalizimin e Çarshisë së Madhe.*

---

## **IV. STRATEGIC FRAMEWORK OF REGENERATION**

*The intentions expressed together with the objectives/ actions set, have created a general concept for the vision and content of the framework for the regeneration of the Grand Bazaar.*






# SYNIMI 1

*Krijimi i kornizës organizative e cila do të bënte koordinimin dhe udhëheqjen e të menduarit strategjik për zhvillim dhe veprime/investime në Çarshinë e Madhe në pajtim me interesat e pronarëve, bizneseve dhe komunës.*

---

## AIM 1

*Creating an organizational framework, which would do the coordination and leadership of the strategic thinking for the development and actions/investments in the Grand Bazaar, in accordance with the interests of owners, businesses and the municipality.*





Funksionalizimi i suksesshëm i Çarshisë së Madhe duhet të mbështetet në vendosjen e një kornize organizative menaxhuese efektive, e cila do të krijonte kushte të përshtatshme për zhvillim, rigjallërim ekonomik dhe përmirësim të përgjithshëm të kësaj zone. Në këtë kontekst synimi është që të themelohet një njësi menaxhuese/zhvillimore, e cila në baza ditore do të jetë përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe promovimin e Çarshisë së Madhe. Kjo njësi në vazhdimësi do të kryente funksionin e ndërlidhjes së sektorit publik dhe atij privat, duke operuar si një entitet i cili do të jetë në gjendje të merr fonde publike dhe private dhe donacione, të cilat nevojiten për realizimin e veprimeve dhe projekteve për funksionalizimin e Çarshisë së Madhe. Komunikimi i rregullt ndërmjet të gjitha palëve është thelbësor, prandaj njësi menaxhuese do të mbajë lidhje me të gjitha institucionet relevante të nivelit qendror, qeverinë lokale, OJQ të ndryshme dhe grupet lokale të interesit. Ajo do të veprojë si një pikë qendrore për koordinimin e zgjidhjeve të çështjeve/problemeve të komunitetit dhe të çfarëdo çështjeve që mund të paraqiten gjatë zbatimit të planit të menaxhimit. Për këtë qëllim, nevojitet sigurimi i fondeve dhe resurseve njerëzore adekuate, në mënyrë që të sigurohet puna e saj në vazhdimësi.

### **OBJEKTIVI 1.1**

#### **THEMELIMI I NJËSISË PËR MENAXHIMIN E ÇARSHISË SË MADHE (NMÇ)**

##### **Veprimi 1.1.1 – Formimi i grupit punues për themelimin e NMÇ-së**

Nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hartimit të këtij dokumenti, është kërkuar themelimi i një njësie përgjegjëse, që do të merret me menaxhimin e të gjitha çështjeve që lidhen me Çarshinë e Madhe. Iniciativa për themelimin e njësisë duhet të merret nga grupi punues i udhëhequr nga institucionet komunale, përkatësisht nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik. Në këtë drejtim, përkrahje duhet të ofrojë edhe Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në kuadër të MKRS-së, të cilët në bashkëpunim me përfaqësuesit e Këshillit të Çarshisë do të hulumtojnë dhe propozojnë opcionet e mundshme të organizimit të njësisë për menaxhimin e Çarshisë së Madhe.

Me rëndësi të veçantë është përcaktimi i qartë i detyrave dhe statusit të kësaj njësie, sipas të cilave duhet të rregullohet: mënyra e organizimit, përbërja, emërimi dhe mënyra e funksionimit; linjat e ardhshme të komunikimit; mënyra e financimit dhe mandati i saj. Kjo iniciativë duhet të jetë në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi, të cilat në mënyrë të qartë e bëjnë ndarjen e përgjegjëse.

The successful regeneration of the Grand Bazaar should be based on establishing an effective organizational management framework, which would create conditions for development, economic recovery and overall improvement of the area. In this context, the aim is to establish a managing/ development unit, which on a daily basis will be responsible for the management and maintenance of public spaces and promote the Great Bazaar. This unit would perform continuously the function of connecting the public and private sector, operating as an entity that will be able to receive public and private funds and donations, which are needed for the implementation of actions and projects for the regeneration of the Grand Bazaar. Regular communication between all parties is essential, therefore the management unit will liaise with all relevant institutions at the central level, local government, various NGOs and local interest groups. It will act as a focal point for the coordination of solutions for issues/ problems of the community and any issues that may arise during the implementation of the management plan. For this purpose, it is necessary to provide adequate funds and human resources, in order to ensure its continuous work.

### **OBJECTIVE 1.1**

#### **ESTABLISHMENT OF THE MANAGING UNIT OF THE GREAT BAZAAR (MUB)**

##### **Action 1.1.1 - Creating the working group for the establishment of the MUB**

The establishment of a responsible entity that will handle the management of all issues related to the Great Bazaar was asked from all the participants in the process of drafting this document. The working group, led by municipal institutions, namely the Department of Economic Development, should take the initiative for the establishment of the unit. In this way, support should also be provided by the Department of Cultural Heritage under the MCYS, which in cooperation with representatives of the Council of the Bazaar will explore and propose possible options for organizing the Managing Unit of the Great Bazaar.

Of particular importance is to clearly define the tasks and status of this unit, according to which should be regulated: the ways of organization, composition, the appointment and way of operation; future communication lines; financing and its mandate. This initiative should be in compliance with applicable laws and regulations, which clearly establish the share of responsibilities.

**Veprimi 1.1.2 – Organizimi i NMÇ-së (propozimet)**

Në kuadër të diskutimeve që u zhvilluan në grupin punues të ekspertëve u propozuan dy opsione të mundshme, modeli i parë është themelimi dhe organizimi i NMÇ si OJQ; ndërsa modeli i dytë është ai i ndërmarrjes publike. Me qëllim të ofrimit të fleksibilitetit në administrim si dhe rritjen e mundësive për financim nga institucionet vendore e ndërkombëtare – u favorizua modeli i funksionimit si OJQ me kusht që të përdoren institucionet ekzistuese. Rrjedhimisht, sekretariati i NMÇ-së mund të vendoset në njërin nga institucionet lokale që janë në funksion (si p.sh. Qendra Inovative e Gjakovës (JIC); Qendra Multifunkionale e Bizneseve apo Zyra Informativ Turistike) në një afat testues prej 2 vitesh. Sekretariati mund të kontraktohet nga menaxhmenti i institucionit të përzgjedhur me detyra specifike të shërbimit për NMÇ-në. Komuna e Gjakovës nevojitet të nënshkruaj Memorandum Bashkëpunimi me menaxhmentin në të cilën saktësohen obligimet e secilës palë me qëllim të funksionimit të NMÇ-së.

Më tutje, njësia për menaxhimin e Çarshisë së Madhe do të udhëhiqet në bazë të Statutit që do të hartohet nga Grupi punues për themelimin e NMÇ-së dhe do të aprovohet nga Komuna pas konsultimit me MKRS.

Modeli final i organizimit dhe funksionimit të kësaj njësie duhet të përcaktohet me Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të autoriteteve komunale, MKRS-së dhe komunitetit të Çarshisë së Madhe, përderisa në vijim janë dhënë disa elemente orientuese për strukturën e mundshme organizative.

**Bordi drejtues** – është përgjegjës për udhëheqjen e Njesisë për menaxhimin e Çarshisë së Madhe dhe është i përbërë prej shtatë anëtarëve, nga të cilët tre janë përfaqësues të komunitetit (një përfaqësues i zanatlinjve, një përfaqësues i pronarëve të dyqaneve dhe një përfaqësues i shtëpive të banimit); tre anëtar të bordit janë përfaqësues nga komuna dhe një tjetër është nga MKRS.

BORDI drejtues i pergjigjet Këshillit të Carshisë. Njëri nga anëtarët e bordit me shumicë votash, do të zgjidhet kryetar me mandat dy vjeçar, me mundësi të vazhdimit varësisht nga performanca e treguar. Pjesë e njesisë duhet të jetë edhe sekretaria, një person me orar të plotë të punës (i emëruar nga komuna dhe pa të drejtë vote), përgjegjës për mirëmbajtjen e të dhënave, të funksionimit të zyrës dhe punëve tjera administrative të zyrës. Zyra e njesisë duhet të jetë në kuadër të Çarshisë, në njërin nga objektet-lokalet e identifikuar si objekte publike.

Bordi i raporton për punën e saj çdo 6 mujore Komunës dhe MKRS-së.

**Action 1.1.2 – The organization of MUB (proposals)**

In the context of the discussions that took place in the working group of experts, two possible options were proposed. The first model is the establishment and organization of MUB as NGO; while the second model is that of a public enterprise.

In order to provide flexibility in the administration and increase of opportunities for financing from local and international institutions - the model of functioning, as NGO was favored, provided to use existing institutions. Consequently, the secretariat of the MUB can be placed in one of the existing and active institutions (such as Gjakova Innovative Centre (JIC); Multifunctional Office for Businesses or Tourist Information Office) in a test period of 2 years. The management of the favored institution may contract the secretariat with specific service tasks for MUB. The municipality of Gjakova should sign the Memorandum of Cooperation with the JIC management, which specifies the obligations of each party with the purpose of functioning the MUB.


Furthermore, the unit for the management of the Great Bazaar will be led under the Statute to be drafted by the Working Group for the establishment of the MUB and be approved by the municipality after consultation with MCYS.

The final model of organization and functioning of this unit should be determined by a Memorandum of Understanding between the municipal authorities, MCYS and the community of the Great Bazaar, while some guiding elements for possible organizational structure are provided in the following.

**The Managing Board** - is responsible for leading the Managing Unit of the Great Bazaar and is composed of seven members, three of them are representatives of the community (a representative of the artisans, a representative of the shop owners and a representative of residential houses); three members of the board are representative of the municipality and the last one is from MCYS.

The Managing Board reports to the Council of Bazaar. One of the members of the board by the majority of votes, would be elected president with a two-year term, with the possibility of extension, depending on performance. The secretary must also be part of the unit, a full time working person (appointed by the municipality), responsible for the maintenance of data, the functioning of the office and other office administrative works. The unit's office must be within the bazaar, in one of the buildings- shops identified as public buildings. Board reports on its proceedings to Municipality and MCYS on every 6 months.





**Fig.6 - Skema e organizimit të Njesisë për Menaxhimin e Çarshisë së Madhe**

**Këshilli i Çarshisë** – është organ që përfaqësohet nga një e treta e të gjitha lokaleve aktive (një lokal një anëtar) & banorëve rezident të Çarshisë. Këshilli është përgjegjës për mbikeqyrjen e punës BORDIT drejtues, aprovimin përfundimtar të planit vjetor të punës dhe propozimin e tre anëtarëve të bordit drejtues. Këshilli takohet rregullisht dy herë në vit, një herë në muajin shkurt kur Bordi drejtues bën prezantimin e planit të punës, dhe një herë tjetër gjatë vitit (sipas nevojës), në të cilin do të shqyrtohet niveli i realizimit të planit. Takimi i këshillit mund të organizohet edhe me iniciativën e të paktën 30 përfaqësuesve të lokaleve aktive apo banoreve rezident të Çarshisë me qëllim të diskutimit dhe gjetjes së zgjidhjes për ndonjë problem eventual. Anëtarët e Këshillit do të përzgjidhen sipas një skeme të përcaktuar në Statutin e punës së Bordit drejtues.

**Financimi** – Njësia për Menaxhimin e Çarshisë (NMÇ) fillimisht duhet të financohet nga institucionet lokale e qendrore, ndërsa paralelisht të krijohen kushte të vetë-financimit kryesisht nga të hyrat vetanake, të cilat krijohen nga participimi i lokaleve aktive dhe dhënia me qira e hapësirave dhe objekteve



**Fig.6 - Organization scheme of the Managing Unit of the Great Bazaar**

**The Council of Bazaar** - a body represented by a third of all active shops & residents in the Bazaar (a local member). The Council is responsible for overseeing the work of The Managing Board, final approval of the annual work plan and proposal of three members of the board of directors. The Council meets regularly twice a year, once in February when the Board does the presentation of the work plan, and another time during the year (as needed), when the level of implementation of the plan will be reviewed. The council meeting can be organized on the initiative of at least 30 active representatives of Bazaar shops or residents, in order to discuss and find solutions of any problems. Council members will be selected under a scheme set out in the Statute of the work of the Managing Board.

**Financing** – The Managing Unit of the Great Bazaar (MUB) should initially be funded by local and central institutions, while simultaneously create conditions of self-financing mainly from the revenues, which are created by

publike në Çarshi. Niveli i participimit dhe i qirave përkatëse do të përcaktohet pas negociatave në mes Bordit drejtues dhe përfaqësuesve të lokaleve. Pjesa tjetër e buxhetit do të sigurohet nga përkrahja e komunës dhe MKRS-së, e cila do të përcaktohet me marrëveshje të mirëkuptimit në mes NMÇ-së, Komunës dhe MKRS-së. Gradualisht, ky financim do të zëvendësohet nga sektori privat, me stabilizimin e mekanizmave të NMÇ-së. Ky buxhet duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar kompensimin e nivelit adekuat për sekretarinë dhe anëtarët e Bordit drejtues dhe për të mbuluar shpenzimet e zyrës, duke përfshirë edhe harxhimet që mund të krijohen nga aktivitetet e ndryshme të Bordit drejtues;

### **Veprimi 1.1.3 – Përcaktimi i mandatit të NMÇ-së**

Detyrat e NMÇ-së kryesisht lidhen me fasilitimin e revitalizimit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Çarshinë e Madhe. Kryetari i Bordit drejtues është përgjegjës për hartimin dhe realizimin e planit vjetor të punës lidhur me organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve në Çarshinë e Madhe, paraprakisht të dakorduar me Bordin drejtues dhe përfundimisht të aprovuar me shumicë të votave nga Këshilli i Çarshisë.

Në një periudhë afatshkurtër, vendosja e një komunikimi të rregullt dhe marrëdhënieve ndërmjet palëve të interesit në Çarshi ka rëndësi kyçe. NMÇ do të ketë rolin kryesor në ngritjen e performancës ekonomike dhe përmirësimin e ofertës së kësaj zone. Kjo nënkupton ndërtimin e një sistemi të organizuar të qiradhënies, ndërtimin e standardeve të operimit të bizneseve, mbështetjen e bizneseve që tërheqin vizitorë dhe rekrutimin e investitorëve të specializuar në fusha të caktuara (tregti, komerciale, hotelieri, banim).

Pjesë e menaxhimit të NMÇ-së duhet të jenë edhe planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve ditore dhe periodike që do të organizohen në Çarshi. Në bashkëpunim me pjesëmarrës tjerë, duke përfshirë edhe ekspertë të fushave të ndryshme dhe me forma të ndryshme, NMÇ do të ofrojë përkrahje dhe stimulimin e aktivizimit të zanateve dhe mirëmbajtjen e tyre. NMÇ do të jetë përgjegjëse për funksionimin e rregullt të infrastrukturës teknike dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, dhe për aktivitete tjera që do të ndihmojnë në funksionalizimin më të mirë të Çarshisë, duke përfshirë edhe përkrahjen e ekipeve profesionale që do të kryejnë punët në trajtimin e duhur të vlerave të trashëgimisë kulturore.

### **Veprimi 1.1.4 – Ndërtimi i linjave të qëndrueshme të bashkëpunimit**

Njëra nga detyrat e rëndësishme të Bordit drejtues është ndërtimi dhe avancimi i linjave të bashkëpunimit me të gjitha palët e interesit duke përfshirë: komunitetin (banorët e shtëpive, pronarët e dyqaneve, bizneset që veprojnë dhe zejtarët aktiv

the participation of active shops and renting public spaces and buildings of Bazaar. The level of participation and the respective leases will be determined after negotiations between the Board and representatives of the shops. The rest of the budget will be provided by the support of the municipality and the MCYS, which will be determined by an agreement of understanding between MUB, municipality and MCYS. Gradually, this funding would be replaced by the private sector, to stabilize the MUB mechanisms. This budget should be sufficient to provide adequate level compensation for the secretariat and members of the Board and to cover office expenses, including expenses that may arise from different activities of the Managing Board;

### **Activity 1.1.3 - Determination of the MUB mandate**

MUB's duties are mainly related to facilitating the economic revitalization and sustainable development of the Great Bazaar. The Chairman of the Board is responsible for the elaboration and implementation of the annual working plan regarding the organization and coordination of activities in the Great Bazaar, previously agreed with the Managing Board and finally approved by the majority of votes by the Council of the Bazaar.

In the short term, the establishment of a regular communication and relationships between the stakeholders of the Bazaar is very important. MUB will have a role in increasing economic performance and improving the offer of this area. This means, building an organized system of leasing, building standards for the operation of businesses, support businesses that attract visitors and recruiting investors specialized in certain areas (trade, commercial, hotel, residential).

Part of MUB's management should also be planning and coordination of activities and daily and periodic events that will be organized in the Bazaar. In collaboration with other stakeholders, including experts from different fields and different forms, MUB will provide support and stimulate the activation and maintenance of crafts. MUB will be responsible for the proper functioning of the technical infrastructure and maintenance of public spaces, and for other activities that will help in better functioning of the Bazaar, including support of professional teams that will work in proper treatment of cultural heritage values.

### **Activity 1.1.4 – Building sustainable lines of cooperation**

One of the important tasks of the Board is to build and upgrade the lines of cooperation with all stakeholders including: community (housing residents, shopkeepers, artisans and operating businesses active in the Bazaar),



në Çarshi), institucionet: qeverinë lokale dhe qendrore, organizatat e ndryshme që veprojnë në Kosovë (OEK dhe odat tjera ekonomike, Aleanca Kosovare e Biznesit,...) dhe grupet tjera të interesit. Është shumë me rëndësi të kuptohet se niveli dhe qëndrueshmëria e këtij bashkëpunimi do të ketë ndikim direkt në shumë aktivitete dhe në funksionalizimin e Çarshisë në përgjithësi.

## OBJEKTIVI 1.2

### SIGURIMI I QENDRUESHMËRISË FINANCIARE

#### Veprimi 1.2.1 – Marrëveshja financiare MKRS-Komuna-NMÇ

Pas themelimit të NMÇ-së, pjesa më sfiduese në rrethanat e sotme në vend do të jetë sigurimi i fondeve të nevojshme për funksionimin normal të NMÇ-së dhe zbatimin e programit për funksionalizimin e Çarshisë në përgjithësi. Në këtë drejtim esenciale do të jetë ndihma (për periudhën fillestare prej tre viteve) që duhet të ofrohet nga institucionet lokale dhe qendrore të vendimmarrjes. Niveli i përkrahjes duhet të përcaktohet me marrëveshje në mes NMÇ-së, komunës dhe MKRS-së, e cila do të obligojë të gjitha palët pjesëmarrëse të realizojnë detyrimet sipas përgjegjësisë. Gradualisht, me konsolidimin e veprimit të NMÇ-së duhet të ndërtohen mekanizma adekuat që do ta rrisin përkrahjen financiare nga ana e sektorit privat.

#### Veprimi 1.2.2 – Përcaktimi i pagesave të participimit dhe shërbimeve

Një pjesë e rëndësishme e fondeve do të sigurohet nga participimi i lokaleve aktive, vlera e të cilit duhet të përcaktohet nga Bordi Drejtues pas bisedave të hapura me përfaqësuesit e lokaleve aktive. Niveli i participimit mund të jetë i ndryshëm në varësi të biznesit, hapësirës së shfrytëzuar dhe qarkullimit mujor të tij. Lokalet joaktive janë të liruara nga ky detyrim, ato bëhen pjesëmarrëse me aktivizimin e biznesit me një vlerë paushalle për tre muajt

institutions, local and central government, various organizations operating in Kosovo (KCC and other economic chambers, Business Alliance of Kosovo) and other interest groups. It is very important to understand that the level and sustainability of this cooperation will have a direct impact on many activities and overall functioning of the bazaar.

## OBJEKTIVE 1.2

### ENSURING THE FINANCIAL VIABILITY

#### Activity 1.2.1 - Financial agreement between MCYS- Municipality-MUB

After the establishment of the MUB, the most challenging part of today's circumstances in the country will be to provide necessary funds for normal functioning of the MUB and the implementation of the program for the functioning of the bazaar in general. Assistance will be essential (for an initial period of three years) to be provided by local and central decision-making institutions. The level of support should be determined by an agreement between MUB, municipality and MCYS, which would oblige all stakeholders to implement the obligations under the responsibilities. Gradually, with the consolidation of the MUB's action, adequate mechanisms that will increase the financial support from the private sector should be built.

#### Activity 1.2.2 - Determination of participation and utility payments

A significant part of the funds will be provided by the participation of active shops, the value of which shall be determined by the Managing Board after open discussions with representatives of active shops. The level of participation can be different depending on the business, utilizing space and its monthly turnover. Inactive shops are exempt from this obligation, they



e parë të përcaktuar nga Bordi, pas kësaj kohe ato futen në sistemin e rregullt të participimit. Po ashtu duhet bërë edhe përcaktimi i tarifave për kryerjen e shërbimeve të lidhura me aktivitetet/ngjarjet e organizuara në Çarshi.

### **Veprimi 1.2.3 – Lobimi për ngritjen e fondeve**

Mundësi tjetër për ngritjen e fondeve janë donacionet dhe ndihmat që mund të ofrohen nga projekte dhe programe të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Aktualisht trashëgimia kulturore është në trend, është njëra nga fushat me interes për shumë organizata që veprojnë në Kosovë. Ky fakt duhet të shfrytëzohet nga Bordi drejtues duke përgatitur kërkesa dhe projekte të qarta për investim.

## **OBJEKTIVI 1.3 MBROJTJA E ZEJEVE NË ZHDUKJE**

### **Veprimi 1.3.1 – Evidentimi i listës së zejeve të rrezikuara**

Bordi drejtues me ndihmën e ekspertëve të fushës, duhet të përcaktojë listën e zanateve të rrezikuara nga zhdukja, të cilat do të marrin ndihmë dhe përkrahjen e nevojshme nga autoritetet përkatëse.

P.sh. duke ju referuar Planit Rajonal të Trashëgimisë për Kosovën Perëndimore (Këshilli i Evropës) - *“Djepi është një nga produktet karakteristike të zdruktharëve të Gjakovës. Zeja dhe të gjitha ritualet e ndërlidhura me këtë proces janë në rrezik të zhdukjes sepse vetëm dy familje ende merren me këtë zeje në Gjakovë. Çdo javë punohen tre apo katër djepa, ndërsa blerësit kryesisht vijnë nga fshatrat e rajonit të Hasit. Ka nevojë urgjente për hartimin e planit për ruajtjen e këtij artizanati dhe për gjetjen e zgjidhjeve për këtë problem; për shembull, kjo zeje do të mund të modifikohet për qëllime të turizmit”.*

Një situatë e ngjashme fatkeqësisht është prezent edhe në zejet tjera në zhdukje si: nallbanët, kutigjinjtë, teneqepunuesit, qeleshepunuesit (plisat), thurjet e ndryshme, qëndisjet me ari, lëkurë punuesit (saraçët), mëndafshpunuesit (kazazët) dhe zejet tjera të rëndësishme dhe atraktive.

### **Veprimi 1.3.2 – Vendosja e mekanizmit për ndihmë/subvencionim të zejeve të rrezikuara**

Vlera dhe forma e ndihmës duhet të definohet me vendim nga autoritetet vendimmarrëse lokale dhe qendrore. Një vendim i tillë do të jetë detyrim për të gjitha palët, duke e përfshirë edhe ushtruesin e zejes i, e cili/cila është i, e obliguar në ushtrimin e drejtë dhe me përkushtim të zejes dhe përcjelljen e saj në gjeneratat e reja.

become participants in the activation of the business with a random value for the first three months set by the Board, and after that time they enter the regular system of participation. The fees for services related to activities/ events organized in the Bazaar should also be determined.

### **Activity 1.2.3 - Lobbying for fundraising**

Another opportunity for fundraising are donations and assistance that can be provided by various local and international projects and programs. Currently, cultural heritage is in trend, it is one of the areas of interest of many organizations operating in Kosovo. This fact should be used by the Board to prepare clear demands and investment projects.

## **OBJECTIVE 1.3 PROTECTION OF CRAFTS IN EXTINCTION**

### **Activity 1.3.1 – Identifying the list of endangered crafts**

The Managing Board with the assistance of experts of the field, should define the list of endangered crafts in extinction, which will receive required assistance and support by the relevant authorities.

E.g., referring to the Regional Heritage Plan for Western Kosovo (Council of Europe) - *“The cradle is one of the characteristic products of woodworkers of Gjakova. Handicraft and all the rituals associated with this process are in danger of extinction, because only two families still work with this craft in town. Each week, three or four cradles are produced, while buyers mostly come from villages of the region of Has. There is an urgent need to draft a maintenance plan for the handicrafts and to find solutions to this problem; for example, this craft could be modified for tourism purposes”.*

Unfortunately, a similar situation is present in other crafts in extinction, such as: farriers, tinsmiths, felt workers (*Plis*- white felt cap), different knit works, gold embroidery, leather makers (saddlers), silk workers (*Kazaz*) and other important and attractive crafts.

### **Activity 1.3.2 – The establishment of a mechanism for assistance/ subsidy for endangered crafts**

The value and form of assistance should be defined by a decision from the central and local decision-making authorities. Such a decision would be an obligation for all parties, including the acting craft, obliged in the right exercise and dedication to the craft, so that new generations can enjoy it.




## SYNIMI 2

Ruajtja dhe shfrytëzimi i veçantisë i Çarshisë së Madhe si vlerë kulturore, artistike dhe historike unike në funksion të gjenerimit të përfitimeve ekonomike me turizmin kulturor në qendër

---

## AIM 2

The preservation and use of the uniqueness of the Grand Bazaar as a cultural, historical, artistic and unique value, in order to generate economic profits with the cultural tourism in the center





**K**ultura është baza e identitetit social dhe zhvillimit të një shoqërie dhe trashëgimia kulturore është vlerë që përcillet brez pas brezi. Rëndësia e saj dhe nevoja për ta ruajtur atë, duhet ti komunikohet komunitetit dhe vizitorëve dhe është një nga synimet kryesore për menaxhim të qëndrueshëm të Çarshisë së Madhe.

Është e rëndësishme që të njihet roli i turizmit kulturor në rritjen e ekonomisë dhe mirëqenies sociale e kulturore të qytetarëve dhe ai duhet mbështetur për aq sa është në përputhje me detyrimin primar të ruajtjes, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë.

Në këtë drejtim komuna duhet t'i kushton më tepër vëmendje kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë dhe pozicionimit të Gjakovës në strategjinë nacionale të turizmit.

## **OBJEKTIVI 2.1**

### **SHNDËRRIMI I ÇARSHISË NË DESTINACION TURISTIK PËR KOMUNËN DHE RAJONIN**

#### **Veprimi 2.1.1 – Intensifikimi i bashkëpunimit me iniciativat turistike rajonale**

Është parë si domosdoshmëri integrimi më i madh i Gjakovës në iniciativat rajonale të turizmit dhe promovimi i një turizmi të qëndrueshëm në Çarshinë e Madhe. Prandaj, përmes ndërlikohjes me rrjetet lokale turistike, duhet të punohet në zhvillimin e një plani rajonal të turizmit, pjesë e të cilit do të jetë edhe Gjakova me trashëgiminë e saj kulturore dhe natyrore.

Bashkëpunimi me sektorin privat, agjencitë e udhëtimit të cilat mundësojnë vendosjen e lidhjeve me agjencitë e huaja, mundëson përfshirjen e vlerave turistike të Gjakovës e në veçanti Çarshisë së Madhe në programet e tyre. Në këtë drejtim, duhet të shfrytëzohet afërsia me kufirin e Shqipërisë, për zhvillimin e turizmit transit krahas llojit kryesor të lëvizjes turistike që është vizita vlerave historike dhe kulturore të Çarshisë së Madhe.

#### **Veprimi 2.1.2 – Brendimi i Çarshisë së Madhe**

Për tu bërë destinacion turistik konkurrenës në rajon, Çarshisë së Madhe nuk i mjaftojnë vetvetiu vlerat e trashëgimisë historike dhe kulturore të cilat ajo i posedon. Prandaj është i nevojshëm krijimi i një brendi turistik, një imazhi identifikues të Çarshisë së Madhe i cili e bën atë të veçantë si destinacion të turizmit kulturor, bazuar në karakteristikat dhe autenticitetin e saj. Këto veçanti përbëjnë një motiv të rëndësishëm për ardhjen e vizitorëve me qëllim

**C**ulture is the basis of social identity and development of a society and cultural heritage is the value inherited from generation to generation. Its importance and the need to preserve it, must be communicated to the community and visitors and is one of the key challenges for sustainable management of the Grand Bazaar.

It is important to recognize the role of cultural tourism in economic growth and social and cultural welfare of the citizens and it should be supported to the extent consistent with the primary obligation of preservation, maintenance and protection of heritage.

In this regard, municipalities should pay more attention to this important branch of the economy and positioning of Gjakova in the national tourism strategy.

## **OBJECTIVE 2.1**

### **THE CONVERSION OF BAZAAR IN TOURISM DESTINATION FOR THE MUNICIPALITY AND REGION**

#### **Activity 2.1.1 - Intensification of cooperation with regional tourism initiatives**

The greater integration of Gjakova in regional tourism initiatives and the promotion of sustainable tourism in the Great Bazaar is a must. Therefore, through liaison with local tourist networks, we should work on the development of regional tourism plan, part of which will be Gjakova with its cultural and natural heritage.

Cooperation with the private sector, travel agencies that enable the establishment of links with foreign agencies, allows the inclusion of touristic values of Gjakova, in particular of the Great Bazaar, in their programs. In this regard, the proximity to the Albanian border should be used, for the transit tourism development along the main type of tourist movement, being that visits to the historical and cultural values of the Great Bazaar.

#### **Activity 2.1.2 - Branding of the Great Bazaar**

To become a competitive tourist destination in the region, historical and cultural heritage values of the Grand Bazaar are not enough. It is therefore necessary to create a touristic brand, an identifying image of the Grand Bazaar, which makes it unique as a cultural tourism destination, based on its characteristics and authenticity. These specifics play an important motive for the visitors to come to recognize and experience them. The essence of a brand



të njohjes dhe përjetimit të tyre. Thelbi i brendimit është harmonizimi i asaj çfarë ofron vendi dhe përmbushjes së pritjeve të vizitorëve.

Struktura dhe përmbajtja e produkteve turistike dhe shërbimeve në Çarshinë e Madhe duhet t'i përshtatet nevojave dhe pritjeve të vizitorëve dhe kualiteti i tyre duhet të mirëmbahet në vazhdimësi.

**Në këtë aspekt, elemente me rëndësi janë:**

- Autenticiteti dhe atmosfera e veçantë – “ndjenja e vendit” (nivel i lartë i rregullimit urban, standardizimi i mobilitetit urbane);
- Monumentet e trashëgimisë kulturore dhe interpretimi i tyre;
- Ringjallja e zejeve tradicionale si atraksion turistik; ekspozita të prodhimeve tradicionale;
- Ekspozita atraktive muzeale;
- Organizimi i manifestimeve kulturore-artistike, me përmbajtje edukative, argëtuese, inovative;
- Oferta hotelierike (lloje të ndryshme kafeterish, restaurantesh, ushqim kualitativ, specialitete lokale, shërbim i mirë...);

**Veprimi 2.1.3 – Promovimi i Çarshisë së Madhe si destinacion turistik**

Për t'u informuar publiku për mundësitë që i ofron Çarshia e Madhe me specifikat e saj, domosdo duhet të shfrytëzohet promovimi si mjet komunikimi. Koncepti i brendit të krijuar duhet t'i komunikohet publikut në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.

**Kjo bëhet përmes mjeteve dhe formave të ndryshme promovuese:**

- Njohja vizuale e destinacionit (shenjat dalluese, reklamat, materiali grafik);
- Shërbimi kualitativ i guidave dhe interpretimit të vlerave që ofrojnë një eksperiencë informative dhe të këndshme për vizitorët;
- Materiale të shtypura (hartat turistike, broshura, prezantime në CD);
- Hapja e pikave informuese (aeroporti, pikat turistike fqinje...);
- Panairët e turizmit dhe organizimet e takimeve promovuese;
- Marketingu në shtypin ditor dhe revistat e ndryshme;
- Marketingu “online” dhe hapja e ueb - faqes së Çarshisë së Madhe;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me operatorët turistik vendor dhe rajonal.

Trendet e promovimit të turizmit janë gjithnjë e më tepër të orientuara kah interneti dhe paisjet mobile. Në këto rrethana, zhvillimi i aktiviteteve promovuese të Çarshisë së Madhe duhet të orientohet kah e-marketingu. Kjo kërkon zhvillim të vazhdueshëm të aftësive organizative dhe komunikuese të

is a harmonization of what the country offers and meeting the expectations of visitors.

The structure and content of tourism products and services in the Great Bazaar should adapt to the needs and expectations of visitors and their quality must be maintained continuously.

**In this respect, important elements are:**

- Unique authenticity and atmosphere - “the feeling of place” (high level of city planning, urban standardization of the urban furniture);
- Cultural heritage monuments and their interpretation;
- The revival of traditional crafts as tourist attraction; exhibition of traditional products;
- Attractive museum exhibitions;
- Organizing cultural-artistic events with educational, entertainment and innovative content;
- Catering offers (different types of cafes, restaurants, qualitative food, local specialties, good service ...);

**Activity 2.1.3 - Promoting the Great Bazaar as a tourist destination**

To inform the public about the opportunities offered by the Great Bazaar with its specifications, its promotion shall be used as a tool for communication. The concept of the created brand should be communicated to the public in a systematic and consistent manner.

**This is done through various means and forms of promotion:**

- Visual recognition of destination (signage, advertising, graphic material);
- Qualitative service of the guides and interpretation of values that offer an informative and enjoyable experience for visitors;
- Printed material (tourist maps, brochures, presentations on CD);
- Opening of info points (airport, neighboring touristic spots ...);
- Tourism fairs and organization of promotional meetings;
- Advertising in newspapers and various magazines;
- “Online” marketing and opening the website of the Grand Bazaar;
- Continued cooperation with local and regional tour operators.

Promoting tourism trends are increasingly oriented to internet and mobile devices. In these circumstances, the development of promotional activities of the Great Bazaar should be oriented towards e-marketing. This requires

kuadrove për zhvillimin e aktiviteteve intensive ndaj agjensioneve turistike, portaleve që rekomandojnë destinacionet, hartuesve të guidave, si dhe rrjeteve sociale.

## OBJEKTIVI 2.2

### NGRITJA E VETËDIJES PËR RUAJTJEN TRASHËGIMISË KULTURORE

Kultura është baza e identitetit social dhe zhvillimit të një shoqërie dhe trashëgimia kulturore është vlerë që përcillet brez pas brezi. Rëndësia e saj dhe nevoja për ta ruajtur atë, duhet ti komunikohet komunitetit dhe vizitorëve dhe është një nga synimet kryesore për menaxhim të qëndrueshëm të Çarshisë së Madhe. Parakusht për ruajtjen e trashëgimisë është njohja e vlerave të saj dhe rëndësinë që ato kanë në afirmimin e identitetit tonë historik dhe kulturor.



#### Veprimi 2.2.1 – Zhvillimi i programit për vetëdijësim të fëmijëve dhe të rinjëve

Edukimi i brezave të rinjë për të kuptuar vlerat e trashëgimisë dhe për të rritur përkushtimin e tyre për ruajtjen e saj është një prioritet i parë në planifikimin e ndonjë fushate për rritjen e vetëdijësimit. Kjo mund të arrihet me metoda kreative pjesëmarrëse, përmes përfshirjes së fëmijëve dhe rinisë në aktivitete edukuese dhe ato të konservimit të trashëgimisë, në shkolla dhe në ambiente të trashëgimisë (diskutime, hulumtime përmes internetit, kuize të diturisë, shfaqje, ekskursionet, etj.). Programi duhet të zhvillohet nga

continuous development of communication and organizational skills of staff for intensive development of activities towards tourist agencies, portals that recommend destinations, guides writers, as well as social networks.

## OBJECTIVE 2.2

### RAISING AWARENESS FOR CULTURAL HERITAGE PRESERVATION

Culture is the basis of social identity and development of a society, and cultural heritage is the value inherited from generation to generation. Its importance and the need to preserve it, must be communicated to the community and visitors and is one of the key challenges for sustainable management of the Great Bazaar. Prerequisite for heritage preservation is the recognition of its values and significance, for the promotion of our historical and cultural identity.



#### Activity 2.2.1 – Development of awareness program for children and youth

The education of young generations to understand the values of heritage and to enhance their commitment to its preservation is a first priority in the planning of an awareness campaign. This can be achieved by creative participatory methods, involving children and youth in educational and heritage conservation activities in schools and heritage environments (discussion, research through internet, knowledge quizzes, exhibitions, excursions, etc.). The program should be developed by the Municipal Department of Education



Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me muzetë, QRTK-në Gjakovë, NMÇ-në dhe me OJQ-të e ndryshme që kanë përvojë në këtë fushë.

#### **Veprimi 2.2.2- Vizitat në muze dhe në lokacionet e trashëgimisë**

Vizitat e organizuara në muzetë dhe vendet e trashëgimisë në komunitet dhe më gjërë, ose jashtë vendit parqesin një aspekt atraktiv të edukimit lidhur me trashëgiminë. Ato mund të kombinohen edhe me vizita në zonat e trashëgimisë natyrore, në mënyrë që të zvillohet një qasje e integruar ndaj çdo forme të trashëgimisë (natyrore dhe kulturore).

#### **Veprimi 2.2.3 – Vizitat në punëtoritë e zejeve tradicionale**

Disa nga zejjet tradicionale me të cilat janë punuar eksponatet e muzeve, mund të zhvillohen ende nga zejtarët të cilët e kanë trashëguar atë nga një gjeneratë në tjetrën, dekada e shekuj me radhë, si: punimi qelesheve, zdrukhtaria, argjentaria, qëndisja, endja e pëlhurave etj. Gjatë vizitave të tilla, nxënësit dhe të rinjtë mund ta kuptojnë lidhjen në mes të identitetit të tyre, trashëgimisë dhe këtyre zejeve tradicionale.

#### **Veprimi 2.2.4 – Publikimi i materialeve vetëdijuese**

Është e rëndësishme përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të komunikimit dhe interpretimit të përshtatura për nevojat e komunitetit vendor dhe për vizitorët e huaj. Ato mund të jenë të formave të ndryshme (fletëpalosje, broshura, video, CD, etj.) dhe të specializuara për komunitete ose fokus grupe të ndryshme. Materiali duhet të jetë i qasshëm për publikun dhe të shpërndahet në media të ndryshme si dhe në ueb-faqen e komunës apo atë të Çarshisë së Madhe.

## **OBJEKTIVI 2.3 MENAXHIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Menaxhimi i trashëgimisë është qasje e re në mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, me të cilën ato nuk trajtohen si të izoluara por të integruara në kornizën zhvillimore të qytetit, në kontekstin e zhvillimit socio-ekonomik dhe hapësinor të tij.

Menaxhimi i trashëgimisë nënkupton përkujdesjen sistematike ndaj këtyre vlerave, në mënyrë që ato t'u barten gjeneratave të ardhshme, si potencial kulturor me interes të përgjithshëm. Kështu menaxhimi i trashëgimisë nënkupton më tepër administrimin e vlerave kulturore dhe sociale, krahas konzervimit të saj.

in collaboration with museums, RCCH, MUB and various NGOs that have experience in this field.

#### **Activity 2.2.2- Visits to museums and heritage sites**

Organized visits to museums and heritage sites in the community and beyond or abroad, present an attractive aspect related to heritage education. They can be combined with visits to areas of natural heritage, in order to develop an integrated approach of all types of heritage (natural and cultural).

#### **Activity 2.2.3 - Visits to workshops of traditional crafts**

The exhibits of museums were produced by some of the traditional crafts, which can be still developed by craftsmen who have inherited it from one generation to another, decades and centuries, such as: fez work, carpentry, silversmith, embroidery, fabrics weaving, etc. During such visits, the students and youngsters can understand the link between their identity, heritage and these traditional crafts.

#### **Activity 2.2.4 - Publication of awareness materials**

Preparation and distribution of communication and interpretation materials adapted to the needs of the local community and foreign visitors are very important. They may be of different types (leaflets, brochures, videos, CDs, etc.) and specialized for the communities or focus groups. The material should be accessible to the public and distributed to various Medias and on the website of the municipality or the Great Bazaar.

## **OBJECTIVE 2.3 CULTURAL HERITAGE MANAGEMENT**

Management is a new approach for the protection and preservation of cultural heritage, wherewith they are not treated as isolated but integrated into the city development framework, in the context of socio-economic and spatial development.

Heritage management means systematic care of these values, so that they could be transferred to the next generations as cultural potential of general interest. Thus, heritage management means more the administration of cultural and social values, in addition to their conservation.

**Veprimi 2.3.1 – Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Çarshisë së Madhe**

Qytetet janë një mjedis i gjallë i cili duhet të ndryshojë vazhdimisht në funksion të nevojave dhe kërkesave të banorëve të tyre. Ky ndryshim duhet të menaxhohet me kujdes, në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i mundshëm negativ në vlerat e trashëgimisë në zonat historike urbane.

Plani i Menaxhimit është dokumenti kryesor me të cilin administrohet një vend i trashëgimisë. Ai i shpjegon vlerat e trashëgimisë së atij vendi, rëndësinë e tyre dhe mënyrën se si do të ruhen ato, si gjatë mirëmbajtjes rutinore e deri te ndryshimet e nevojshme gjatë zhvillimeve të reja. Përmes të kuptuarit të rëndësisë së trashëgimisë së një vendi, një plan i menaxhimit të trashëgimisë i përcakton veprimet e nevojshme për ta ruajtur atë.

Kështu, përfshirja e MKRS-së përkatësisht QRTK-së Gjakovë në procesin e hartimit të Planit të menaxhimit të Çarshisë së Madhe është e domosdoshme, duke pasur parasysh se një plan i tillë duhet të përgatitet nga profesionistë të fushës me përvojë në vlerësimin e trashëgimisë dhe dizajnimin e masave për konzervimin e saj.

**Veprimi 2.3.2 – Ri-përdorimi i objekteve të trashëgimisë**

Adaptimi i ndërtesave historike me qëllim të ripërdorimit të tyre konsiderohet të jetë pjesë integrale e konzervimit. Kjo përveç efekteve pozitive që ka në ruajtjen e vlerës kulturore të ndërtesave, sjellë vlerë të shtuar edhe në aspektin social dhe ekonomik të tyre.

Adaptimi duhet të ketë ndikim minimal në vlerat e trashëgimisë së objektit dhe rrethinës së tij dhe duhet të bëhet nën mbikqyrjen e ekspertëve të konzervimit. Përdorimi i ri duhet të zgjidhet me kujdes, ashtuqë të shmangët konflikti ndërmjet ruajtjes së vlerave të objektit dhe përmirësimit të nevojshëm për ta bërë atë të përshtatshëm për përdorim të ri.

Meqenëse komuna ka në pronësi një numër objektesh në zonën e Çarshisë së Madhe, duhet të planifikohet ripërdorimi i tyre, qoftë për nevoja të administratës komunale, ose për përmbushjen e funksioneve kulturore dhe sociale të zonës.

Dhënia me koncesion mund të jetë njëra nga format e shfrytëzimit dhe ruajtjes së objekteve të tilla, nga e cila përfiton edhe komuna edhe koncesionari.

**Activity 2.3.1 – Drafting the Management Plan of the Great Bazaar**

Cities are a living environment that must constantly change for the needs and demands of their residents. This change must be carefully managed in order to reduce the possible negative impact on the heritage values of historic urban areas.

The Management Plan is a key document, which administers a heritage site. It explains the heritage values of a site, its importance and how to preserve it, as during routine maintenance to necessary changes during new developments. Through understanding the importance of a country's heritage, a management plan determines the necessary actions to preserve it.

Thus, the inclusion of MCYS, respectively RCCH in the process of drafting the Management Plan of the Grand Bazaar is a must, given that such a plan should be drafted by experienced professionals in the field of heritage assessment and design measures for its conservation.

**Activity 2.3.2 – Adaptive reuse of built heritage**

The adaption of historical buildings in order to reuse them is considered to be an integral part of conservation. In addition to the positive effects it has on the preservation of the cultural value of the buildings, it brings added value in terms of their social and economic development.

Adaption should have minimal impact on the built heritage values and its surroundings and should be done under the supervision of conservation experts. The new use should be chosen carefully to avoid conflict between preservation of building values and improvement needed to make it suitable for new use.

As the municipality owns a number of buildings in the Grand Bazaar area, it should be planned how to reuse them, whether for the purposes of the municipal administration, or the fulfillment of the social and cultural functions of the area.

Concession may be one of the forms of use and preservation of such buildings, of which benefit both the municipality and the concessionaire.




## **SYNIMI 3**

**ZHVILLIMI I LËVIZSHMËRISË/TRAFIKUT  
DHE NGRITJA E KUALITETIT TË HAPËSIRAVE PUBLIKE**

### **AIM 3**

**DEVELOPING MOBILITY/ TRAFFIC  
AND IMPROVING THE QUALITY OF PUBLIC SPACES**





Zona ku sot ndodhet Çarshia e Madhe e Gjakovës, në fazën fillestare të krijimit të saj ka qenë rezultat i kërkesave që lidheshin kryesisht me zhvillimin e tregtisë dhe ofrimin e shërbimeve elementare të kohës, të cilat u vendosën në hapësira dhe objekte përkatëse. Forma e saj organike e zhvillimit ishte hapësirë e mjaftueshme për zhvillimin e zejeve dhe tregtimin e mallrave të nevojshme për një vendbanim që po ngrihej përreth një bërthame urbane të vogël në të cilën ofroheshin edhe disa shërbime elementare, duke përfshirë edhe Xhaminë si objekti qendror i saj. Rrugët që u zhvilluan përreth kësaj bërthame ishin të mjaftueshme për lëvizjen e lirë të qytetarëve, për ushtrimin e zejeve të ndryshme, për ekspozimin e mallrave dhe për transportimin e tyre me qerre në tërheqje, pa krijuar në asnjë rast momente të vështira të lëvizjes. Për një kohë relativisht të shkurtër, u ndërtuan dyqanet e para si nevojë për të ofruar shërbime më të mira dhe tregtim më human të mallrave. Fillimisht ato u ndërtuan përreth Xhamisë për të vazhduar në mënyrë progresive në të gjithë zonën. Gradualisht, hapësira e Çarshisë po bëhet për ditë më e ngushtë si pasojë e kërkesave gjithnjë në rritje, që ishin rezultat i zhvillimit ekonomik dhe i ndryshimeve të mëdha teknologjike. Për të ardhur deri në ditët e sotme, kur rrugët dhe hapësirat e Çarshisë janë të pamjaftueshme për të mundësuar paralelisht lëvizjen e makinave, lëvizjen e papenguar të këmbësorëve, mundësinë për të zhvilluar dhe ofruar shërbimet e nevojshme dhe në të njëjtën kohë të mundësohet përjetimi i papenguar i vlerave të saj.

Duke pasur këtë parasysh dhe me qëllim të ndryshimit të situatës, janë propozuar objektivat dhe veprimet e mëposhtme:

### **OBJEKTIVI 3.1**

#### **REDUKTIMI I KONFLIKTEVE NË MES KËMBËSORËVE DHE AUTOMJETEVE**

##### **Veprimi 3.1.1- Ndryshimi i sistemit të lëvizshmërisë/trafikut në zonë dhe përreth saj.**

Gjatë shqyrtimit të rrjetit të rrugëve vëmendja kryesore duhet të jetë e drejtuar në sigurinë, lëvizshmërinë dhe rehatinë e këmbësorëve. Të gjitha rrugët që shtrihen në zonën e bërthamës duhet të shkarkohen maksimalisht nga lëvizja e mjeteve motorike, duke ndryshuar kahjen ekzistuese të lëvizjes së automjeteve dhe duke vendosur një orar të përshtatshëm të lëvizjes për furnizim. Shndërrimi i rrugëve njëdrejtimeshe në dydrejtimeshe, me qëllim të funksionimit më të mirë të qarkullimit për automjetet dhe zvogëlimin në maksimum krijimin e “fytit të ngushtë” në lëvizje. Është i domosdoshëm

The area where today is situated the Great Bazaar of Gjakova, in the initial stage of its development has been the result of claims related mainly to the development of trade and the delivery of basic services of the time, which were placed in relevant spaces and buildings. Its organic form of development was a sufficient space for the development of crafts and trading goods necessary for a settlement that rose around a small urban core, which also offered some basic services, including Mosque as its central building. Roads that were developed around this core were enough for the free movement of citizens, for the exercise of different crafts, the exhibition of goods and their transport cart in tow, without creating any difficult moment of movement. For a relatively short time, first stores were built as a need to provide better and more humane trade of goods. Originally they were built around the mosque to continue progressively throughout the area. Gradually, every day, the Bazaar area is getting tighter as a result of increasing demands, as a result of economic development and of great technological changes. To come up to the present day, the streets and bazaar areas are insufficient to enable parallel movement of the car, unimpeded pedestrian movement, the ability to develop and deliver necessary services and at the same time enable the experience of its unrestricted values.

Having this in mind and in order to change the situation, the following objectives and actions were proposed:

### **OBJECTIVE 3.1**

